

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7755 E diel 6 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga JORGJI KOTE



Këtë vit do të përkujtohen katër ngjarje madhore historike të lidhura ngushtë me të ardhmen evropiane e më gjerë; në fillim të qershorit, 75-vjetori ...
Vijon në faqen 21

Vit i mureve ndarës apo urave bashkuese?

Opinion i Ditës

Nga ELVIS HOXHA



Protesta e studentëve është më së pari protestë për rrëzimin e ligjit të arsimit, së dyti rrëzim i tarifave të marrëzisë së masterit, së treti rrëzimin e idesë së ...
Vijon në faqen 22

Proteston, prandaj ekziston



Vjetërsia në punë për çdo kategori
Si ndryshon moshja e daljes në pension për burrat e gratë gjatë vitit 2019

Tabelat/ Formula e llogaritjes, nevojiten 35 vite kontribute për pension të plotë

Prej janarit të vitit 2019, do të ketë ndryshime të moshës së daljes në pension për të gjithë individët që kanë minimumi 15 vite pune me kontribute. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot moshën e daljes në pension për 2019-ën si dhe 2020-ën. Aktualisht për vitin 2018-të, moshja e daljes në pension sipas nenit 43, për gratë është 60 vite e 8 muaj (rritjet ...
Në faqet 8-9

GAZMEND MUSTA MASAKROI 28 HERE ME THIKE BASHKESHORTEN DHE 18-VJEÇAREN

RREFIMI NE GJYKATE: PSE I VRAVA GRUAN DHE KUNATEN

Krimi në Ballsh, 34-vjeçari në Gjykatën e Krimeve të Rënda: "Më ofenduan, nuk durova dot. Jam penduar, qaj hallin e fëmijëve". Pas vrasjeve telefoni babain



(Në foto) Viktima Gentiana Çauhaj me bashkeshortin dhe fëmijet. Gazmend Musta, dje në Gjykatën e Krimeve të Rënda

DRAMA NE GREQI

Shqiptarja u vra nga i ati, i dashuri afgan: E denoncoi një vit më parë

Në faqen 6

KRYETARI I PD

Basha: Regjimi po përçan shqiptarët, mosbesimi është investimi kryesor

Në faqen 4

KRYETARJA E LSI

Kryemadhi: Rama me qeveri UFO-sh, ministrat pa asnjë lloj identiteti

Në faqen 3

ANALIZA

Shifrat e frikshme të ISHP-së, 29 mijë aborte në 5 vitet e fundit në Shqipëri

Në faqen 7

"OK" PER ERION BRAÇEN



Meta nuk dekreton shkarkimin e Ditmir Bushatit, pezull 5 ministra të tjerë

Në faqen 3



Nga Diokleciani te Kostandini i Madh, 27 emrat që sunduan Romën

Perandorët romakë me prejardhje ilire

Në brendësi: Historia e poezisë shqiptare në Francë, skulptura e Krisikos

Nga GAZMEND ÇITAKU

Shqiptarët padyshim që i takojnë trugut të popujve më të lashtë si për nga historia ashtu edhe për nga gjuha. Mirëpo shqiptarët janë një ndër popujt të cilët më së paku e kanë të dokumentuar historinë e vet kom-



bëtare. Periudha e hekurit por edhe ajo antike janë periudha shumë të lavdishme të ilirëve si paraardhësit tanë. A ishin të civilizuar? Me çfarë teknike dhe si i ndërjuan vendbanimet e veta? Nëse dimë se muret ciklopike janë karakteristike e ndërtimeve ilire ...

Suplement

QEVERIA DEKRETI

Pa ambasador amerikan, ish-zv.ministrja: Priten risi në marrëdhëniet me SHBA

Emërimi i Cakajt, Harxhi: Duhet një figurë më e konsoliduar

"Djalë simpatik nga Kosova, shkroi fjalimet e Ramës"

Për Edith Harxhin, drejtoreshë Ekzekutive e "Albanian Policy Center" dhe ish-zëvendësministre e Punëve të Jashtme, zoti Gent Cakaj është një djalë simpatik, por që për Ministrinë e Jashtme sipas saj do të duhej një figurë më e konsoliduar në aspektin jo vetëm të politikës së jashtme dhe të diplomacisë, por edhe në njohuritë e politikës së brendshme të Shqipërisë. Harxhi vlerësoi punën e zotit Cakaj në Shqipëri si zëvendësministër i Punëve të Jashtme, por edhe si këshilltar në kabinetin e kryeministrit Rama. Harxhi madje tha se Cakaj ka pasur një detyrë të rëndësishme, siç është shkrimi i fjalimeve diplomatike për kryeministrin. "Personalisht e njoh zotin Caka, është një djalë i ri simpatik nga Kosova, i cili ka shërbyer mjaft mirë këtu menjohuri, kur ka punuar në kabinetin e kryeministrit Rama. Mesa di unë, ai ka qenë këshilltar pranë kryeministrit, ka pasur edhe një pozicion kyç shumë të rëndësishëm, që në SHBA është shumë i rëndësishëm, shkrimi i fjalimeve diplomatike të një kreu shteti që janë shumë të rëndësishme. Nuk mundet kurrë të akuzoj dikë që është emëruar në këtë pozicion, për arsye sepse ai ose ajo është nga Kosova. Përkundrazi, mendoj se është një gjë shumë e madhe, shumë e mirë që dikush të jetë nga Kosova dhe të emërohet. Por në këto momente që është Shqipëria do të duhej një figurë më e konsoliduar në aspektin jo vetëm të politikës së jashtme dhe të diplomacisë, por edhe në njohuritë e politikës së brendshme të Shqipërisë, por edhe në njohuritë e rajonit në të njëjtën kohë. Sepse këto do të jenë pikat kryesore të një ministri të Jashtëm të Shqipërisë", tha Harxhi për "Ora Neës". "Së dyti - shtoi ajo - jemi para një sfide, hapja e negociatave në BE. Ministri i Jashtëm, kushdo që të jetë duhet të marrë parasysh që do të drejtojë jo vetëm ekipin negociator, megjithëse z.Cakaj është emëruar si kryenegociator para disa muajsh nga Rama. "Edhe këtë e shoh me dyshim, sepse do të duhej një njeri me eksperiencë shumë të madhe me BE, por edhe në politikën e brendshme të Shqipërisë. Është pozicioni kyç i shtetit shqiptar pas atij të kryeministrit, sidomos në këto momente kur ka sfida të tilla", tha ish-zëvendësministria e Punëve të Jashtme.



Ish-zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Gent Cakaj

Studenti: Vajza e deputetit të PS po përpiqet të përçajë protestën

Dy studentë të Fakultetit të Ekonomisë ishin të ftuar dje në rubrikën "Opinion" në studion e lajmeve në "News 24" për të folur për protestën e studentëve që pritet të rinisë të hënën. Andi Varosi dhe Manuela Xhaxho thanë se protesta do të rinisë me të njëjtin intensitet deri sa të përmbushen kërkesat e studentëve. Të pyetur nëse protesta është e politizuar, studenti Varosi akuzoi vajzën e deputetit socialist Pjerin Ndreu se po përpiqet të përçajë protestën. "Në këtë protestë i kemi parë të gjitha. Kjo protestë na ka bërë 'CIA', se kemi filluar të themi dhe ne vetë. Kryeministri në momentin që nxori 11 VKM në fund tha një fjalë: Unë do të



kap protestën e studentëve. Ju garantoj juve se protestat e studentëve që nga fillimi e deri në fund nuk ka shans ta kapë kush. Kur nuk e kanë kapur deri tani, s'do e kapin. Çfarë është tentuar këto ditë pasi dështuan? Jo më përmas forumeve që dështuan, por është tentuar me eksponent të veçantë. Ishte një grup i vogël studentësh me datën 2, se mora vesh që do takoheshin,

atje u takuan me 15 studentë dhe takimi ishte organizuar nga një vajzë dhe vajza sapo filloi ai që quhej takim doli në krye të tavolinës dhe tha sot jemi mbledhur këtu se kemi vendosur që më dt. 7 të organizojmë një koncert përballë korpusit për të shtensionuar situatën. Pyetja është pse duhet ta bëjmë këtë? Se kemi protestuar mbi 30 ditë dhe s'kemi bërë asnjë gjë. Ne do protestojmë para Kryeministrit se vetëm ai thotë se na ofron zgjidhje dhe aty do e vazhdojmë luftën tonë. Protesta s'është tallava. Personi që e ka bërë këtë është Renalda Ndreu, vajza e deputetit socialist, Pjerin Ndreu", tha Varosi.

AMBASADORJA

Prej rreth 7 muajsh, selia diplomatike më e rëndësishme në Tiranë, ajo e SHBA-ve është pa ambasador, pas largimit të Donald Lu-së. Shkak është bërë mosmarrja në shqyrtim e kandidatit të presidentit Donald Trump, Kathleen Ann Kavaliec nga Komiteti i Marrëdhënieve të Jashtëm të Senatit. Njëhësja

e marrëdhënieve ndërkombe të Edith Harxhi, shprehet se emërimi i ambasadorit do të ishte një mesazh i rëndësishëm për marrëdhëniet e reja mes SHBA-ve dhe Shqipërisë. "Arsyet pse është kthyer nga senati amerikan nuk mund t'i them, sepse në deklaratën që ka pasur dje senati nuk ka pasur diçka të shkruar për sa u përket ar-

syeve. Jam e sigurt që ato mund të mbeten edhe në analet e brendshme të senatit, të kongresit apo dhe në administratë brenda", deklaroi zj. Edith Harxhi. Ajo shprehet se Presidenti Trump ka një interes të lartë për Shqipërinë dhe vendet e Ballkanit dhe se shumë shpejt do të ketë një emër të konkretizuar për ambasador. "Në ditën e zhvilli-

DIPLOMACIA

"Në këto momente që është Shqipëria do të duhej një figurë më e konsoliduar në aspektin jo vetëm të politikës së jashtme dhe të diplomacisë, por edhe në njohuritë e politikës së brendshme të Shqipërisë, por edhe në njohuritë e rajonit në të njëjtën kohë", tha Harxhi.

SHKURT


63 ditë protestë tek Unaza e Re, Balliu: Të bashkohemi me studentët

Protesta e banorëve të Unazës së Re dolën është në ditën e 63-të të saj me thirrjen kundër qeverisë "Rama" dhe kundër projektit që parashikon prishjen e shtepive të tyre. Banorët kundërshtojnë prishjen e banesave të tyre, siç e parashikon plani për ndërtimin e aksit nga sheshi "Shqiponja" deri te mbikalimi pranë pallatit me shigjeta, si dhe kërkojnë rrezimin e projektit. Për shkak të protestës u bllokua trafiku. Deputeti demokrat, Klevis Balliu, ishte prezent në protestë, duke mbështetur banorët. Ai bëri apel për bashkim me studentët, që kanë lajmëruar se të hënën rinisin protestat. "Edi Rama është e keqja, shporreni të keqen", tha Balliu. Ky i fundit bëri një apel edhe për kryeprokuroren e përgjithshme të përkohshme, Arta Markun, të cilës i kërkoj të zbardhë aferën korruptive të tenderimit të njerit prej loteve të Unazës.

Karta e identitetit, MB: Aplikoni, nëse skadon brenda 6 muajsh

Ministria e Brendshme bën një tjetër apel për të gjithë shqiptarët që u skadon karta e identitetit. "Verifiko afatin e vlefshmërisë së kartës së identitetit! Nëse ajo skadon në 6-mujorin e parë të vitit 2019, mos e lër për ditën e fundit. Apliko më herët për t'u ripajisur me kartë ID, evito radhën! Me kuponin për kartën e ID, që e gjen në çdo zyrë të Postës Shqiptare paraqitu pranë zyrtarëve të 'Alet!', thuhet në deklaratën e Ministrisë së Brendshme.

meve aktuale të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane unë besoj se do të kemi shumë shpejt një emër dhe një ambasador do të konkretizohet shumë shpejt në Shqipëri", theksoi zj. Harxhi. Ka dyshime se refuzimi nga senati i Kathleen Ann Kavaliec, e cila tani mban detyrën





Kryeministri Edi Rama gjatë takimit me ministrat e shkarkuar dhe ministrat e rinj

Rama dërgon emrat në Presidencë. Edhe 5 ditë afat për dekretimin kushtetues

Meta dekreton 4 nga 9 ministrat e rinj, s'ka firmë për Bushatin

"Pezull" 5 emrat që nuk janë deputetë

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta hedh firmën për shkarkimin e ministrave dhe emërimin e disa prej emrave. Por z.Meta nuk ka krijuar ende bindjen e plotë për lirin nga detyra të ministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati. Kreu i shtetit dekretoi dje emrat e katër ministrave, Elisa Spiropali, Erion Braçe, Eduard Shalsi dhe Bledi Çuçi, për të cilët nuk ka nevojë për proces verifikimi, për shkak se janë deputetë. Ndërsa propozimi për Genti Cakajn si ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, që është zgjedhur nga kryeministri Rama në vend të Bushatit është në proces verifikimi, bënë me dije burime nga Presidencia. Dekreti i parë për shkarkimin nga detyra ishte ai i ministres së Arsimit, Lindita Nikolla, për të vijuar me ministrat Niko Peleshi, Mirela Kumbaro, Damian Gjiku, Arben Ahmetaj, Sonila Qato dhe zëvendëskryeminstren Senida Mesi. I vetmi ministër që vijon të qëndrojë në detyrë, për të cilin Presidenti Meta nuk ka firmosur ende shkarkimin është ai i Jashtëm, Ditmir Bushati. Shkarkimet janë shoqëruar edhe me dekretimet e disa prej emrave të propozuar nga kryeministri Rama, por edhe këtu kreu i shtetit ka qenë i kursyer në firmat e hedhura. Për 5 emrat e tjerë të propozuar nga kryeministri Rama, Genti Cakaj si ministër i Jashtëm, Besa Shahini tek Arsimit, Anila Denaj te Financat, Elva Margariti ministrë e Kulturës dhe Belinda Balluku për Infrastruktura, që nuk janë deputetë, kreu i shtetit mësohet se do të mbledhë informacion përpara se të shprehet me dekret. Kjo është hera e dytë që Presidenti Meta nuk dekreton menjëherë ministrat e kabinetit "Rama". Pak kohë më parë një përplasje me institucionin të Presidencës dhe Kryeministrit u shënuar për dekretin e ministrit të Brendshëm, Sander Lleshaj, për të cil-



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

NGËRÇI

Ende pa dekretuar kanë mbetur të zgjedhurit e Ramës jashtë parlamentit, pra ministrat që nuk kanë mandat deputeti. Në faqen zyrtare të Presidencës nuk ka ende dekret për ministrat Besa Shahin, Elva Margariti, Anila Denaj dhe Genti Çaka dhe Belinda Balluku.

AFATI

Presidenti Ilir Meta ka afat 7 ditë për të dekretuar lirin nga detyra të ministrave të shkarkuar dhe për të dekretuar emërimin e ministrave të rinj, që u prezantuan nga kryeministri Edi Rama në Asamblenë e Partisë Socialiste në fund të dhjetorit 2018.

"Duhet një qeveri që u shërben qytetarëve"

Kryemadhi: Rama me një qeveri UFO-sh, asnjë lloj identiteti

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste, Monika Kryemadhi, u bëri dje thirrje shqiptarëve t'i bashkohen protestës studentore ditën e hënë. Gjatë një takimi me komitetin drejtues të LRI-së së Fierit, Kryemadhi tha se kjo protestë nuk është partiake, por është protestë politike, e cila në thelb ka kërkesat ekonomike, sepse çdo shqiptar pa dallim bindjesh politike ka probleme financiare. Kryemadhi i quajti ndërrimet e bëra në qeveri një manovër të Ramës për të shpëtuar veten dhe fytyrën e tij, ndërkohë që qeverinë e quajti "qeveri UFO-sh, me ministra që nuk kanë asnjë lloj identiteti". "Ka ardhur koha për të protestuar për një jetë më të mirë, duhet të protestojmë për një qeveri, e cila u shërben qytetarëve të saj dhe jo një qeveri që i vjedh qytetarët e saj. Duhet të protestojmë për kërkesat e studentëve, sepse qeveria ose ministrat që ikën, dolën dhe folën për koncesionet që kanë firmosur ditën që i ka shkarkuar Edi Rama, por asnjëri nuk foli për 8 kërkesat e studentëve. 8 kërkesat e studentëve janë shumë të thjeshta, vetëm në 31 dhjetor, Damian Gjiku ka dhënë 58 milionë euro koncesion për TEC-in e Vlorës dhe nuk i kushtonte asnjë gjë Edi Ramës të mos i jepte këto për TEC-in e Vlorës për koncesione. Por le t'ua jepte studentëve dhe u mbyllte kërkesa e parë, ajo që është përgjysmimi i tarifave të studentëve", tha Kryemadhi. Kryetarja e LSI nënvizoi se të gjithë shqiptarët duhet të protestojnë së bashku me studentët, pasi Shqipëria ka nevojë për një qeveri, e cila u shërben qytetarëve të saj dhe nuk i vjedh ata.



DEKRETI

► Presidenti Meta firmosi dekretet për shkarkimin e

- 1-Lindita Nikollës
- 2-Damian Gjiku
- 3-Arben Ahmetaj
- 4-Senida Mesi
- 5-Niko Peleshi
- 6-Mirela Kumbaros
- 7-Sonila Qatos

Nuk u firmos

- Nuk ka dekretuar shkarkimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati
- Ka firmosur deri tani dekretet për emërimet:

- 1-Erjon Braçe
- 2-Eduard Shalsi
- 3-Bledi Çuçi
- 4-Erisa Spiropali

► Nuk janë dekretuar ende emërimet e:

- 1-Besa Shahini
- 2-Gent Cakës
- 3-Anila Denaj
- 4-Elva Margariti
- 5-Belinda Ballukut

Protesta e studentëve, Berisha e Spaho: Bashkohuni!

Opozita u bëri dje thirrje të gjithë shqiptarëve që t'i bashkohen ditën e hënë në orën 10:00 protestës së studentëve. Ish-kryeministri Sali Berisha përmes një postimi në "Facebook" u ka bërë thirrje qytetarëve që të bashkohen me studentët, në orën 10:00 para Kryeministrit. "Bashkohuni me studentet, ditën e hënë, 7 janar, ora 10:00 para Kryeministrit!", shkruan Berisha. Ndërsa kreu i grupit parlamentar të PD, Edmond Spaho, shkruan: "Të gjithë shqiptarët duhet t'u bashkohen studentëve për të mundur Ramën".



in kryeministri Rama u shpreh se do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duke i kërkuar që të interprotojë nëse kreu i shtetit ka të drejtë të mos dekrettojë një ministër. Burimet brenda Presidencës bëjnë me dije se qeveria ka dorëzuar mbremjen e së premtes kërkesën për dekretimin e ministrave të rinj. Ministrat e rinj u propozuan në 28 dhjetor në Asamblenë Kombëtare të Partisë Socialiste dhe presidenti ka 7 ditë kohë ligjore për t'i dekretuar. Shtatë ministrat e rinj të qeverisë "Rama 2" vijonë kryesisht nga administrata shtetërore, ndërkohë që Erjon Braçe do emërohet zv.kryeministër në vend të Senida Mesi. Ndërkohë dy ministrat janë nga Kosova. Në konferencën e fundit Rama shprehu bindjen se Meta nuk do krijonte pengesa për dekretimin e tyre. Pritet që më 21 janar kur të rinisë parlamenti, ministrat të votohen dhe të marrin zyrarisht detyrën. Bazuar në nenin 98 të Kushtetutës, Presidenti Meta ka një javë kohë për t'u shprehur me dekret për 5 ministrat që vijnë të jenë ende pezull dhe dekreti i kreu të shtetit shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi. Edhe në rast të firmës së Presidentit në favor të 5 emrave që ende nuk janë dekretuar, ministrit e rinj do të jenë pjesë e kabinetit qeveritar vetëm pasi të votohen në parlament dhe për këtë do të duhet të presin nisjen e sesionit të ri parlamentar në 21 janar.

PËRVJETORI MESAZHET

Valentina Madani

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha uroi dje 28-vjetorin e themelimit të "Rilindjes Demokratike", gazetës së parë të lirë pas rënies së diktaturës komuniste. Në 28-vjetorin e themelimit të "Rilindja Demokratike", gazeta zyrtare e Partisë Demokratike, Lulzim Basha shprehet se në vend ka nevojë për media që i shërbejnë mirinformimit të publikut. Kreu i demokratëve shprehet se vetëm qytetarët e mirinformuar mund të ruajnë lirinë dhe demokracinë e një vendi. Lulzim Basha akuzon qeverinë kur shprehet se po grabit dhe përçan qytetarët. Kryetari i PD-së u ka bërë apel edhe gazetarëve që me kurajë dhe vendosmëri të përbushin misionin e tyre. "Si sot 28 vite më parë lindi bashkë me shtypin e lirë 'Rilindja Demokratike'. E para media opozitare në Shqipëri pas 45 vitesh diktaturë erdhi në jetë bashkë me pluralizmin politik dhe me lirinë e shprehjes. Në betejë prej ditës së parë me gënjeshtat, manipulimin dhe propagandën komuniste, 'RD' arriti brenda një kohe të shkurtër të kthehej në manualin e ideve të demokracisë, të pluralizmit dhe evropianizmit. Kështu, ajo ishte edhe fidanishja e brezit të parë të gazetarëve dhe analistëve të medias dhe të fjalës së lirë. Bashkëndaj sot me mijëra qytetarë mirënjohjen e thellë për të gjithë gazetarët dhe drejtuesit e RD-së në vite, që me kurajë, mençuri dhe vendosmëri kontribuan për lindjen dhe rritjen e RD duke triumfuar mbi presionet, kërcënimet dhe shantazhet", shprehet z.Basha. Kreu i PD-së përmendi se, "me kontributet e saj për lirinë 'Rilindja Demokratike' ka përherë një vend të veçantë në historinë e medias dhe të demokracisë shqiptare". "Një falënderim të veçantë kam për Bledi Kasmin dhe gazetarët e bashkëpunëtorët e sotëm të 'Rilindjes Demokratike', të cilët vazhdojnë çdo ditë betejën për të vërtetën, në shërbim të Shqipërisë dhe shqiptarëve. 'Rilindja Demokratike' është sot një nga të paktat media të lira në Shqipëri, që lufton për interesin publik. Urimi im është që të vazhdojë të mbetet përherë e tillë. Sot Shqipëria ka nevojë më shumë se kurrë për media që i shërben të vërtetës, mirinformimit dhe vetëdijësitimit të njerëzve. Vetëm qytetarët e mirinformuar mund të ruajnë lirinë, demokracinë

28-vjetori i "RD", kreu i opozitës: Shqiptarëve u duhet një media që thotë të vërtetën

Basha: Regjimi "Rama" po grabit dhe përçan shqiptarët

"Mosbesimi, investimi më i rëndë i qeverisë"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

"Shqipëria, vendi më i varfër në Europë"

PD, Çupi: Rama i preferuar nga oligarkët, i urreyer nga shqiptarët

Deputetja e PD-së, Dhura Çupi ironizoi dje qeverinë "Rama", sipas së cilës ka arritur një tjetër rekord, "ta shënojë vendin në krye të klasifikimit për varfërinë në Europë". Sipas Çupit, kryeministri Rama mund të shpallet si kryeministri i preferuar nga oligarkët dhe më i urreyer nga shqiptarët. "Rekordi i radhës i qeverisë 'Rama' shënohet për klasifikimin në krye të varfërisë për Europën. Kjo renditje e shpall kryeministrin më të dashur për oligarkët e tij e më të urreyerin për Shqiptarët. I pari për pasurinë vetjake dhe i fundit për pasurinë e qytetarëve shqiptarë. Kështu, sipas të dhënave nga statistikat eu-



ropiane, veriu i Shqipërisë është rajoni më i varfër në Europë, ku të ardhurat e banorëve janë sa 24% e mesatares së Bashkimit Europian. Rajoni i tretë më i varfër i Europës është jugu i Shqipërisë, me 29.52% të mesatares së Bashkimit Europian. Të ardhurat

për frymë të Shqipërisë janë sa rreth 30% e mesatares së BE-së, duke e renditur edhe si shtet më të varfër in Europës. Serbia dhe Maqedonia e kanë këtë tregues në rreth 37% dhe 35% përkatësisht, ndërsa në Mal të Zi është rreth 40%", thekson Çupi.

dhe të vetëqeverisjes. Mosbesimi, helmi i dyshimit që krijm çdo shpresë për ndryshim është investimi më i rëndë i regjimit aktual që të vazhdojë të sundojë, grabisë dhe përçajë shqiptarët", de-

klaroi z.Basha. Lideri i PD-së përmendi se: "Shqiptarët kanë nevojë të besojnë tek vetja, te njëri-tjetri, te ndryshimi dhe tek e ardhmja. Ndaj këtë ditëlindje të medias së lirë, ju uroj

gazetarëve dhe njerëzve të fjalës kurajë, besim dhe vendosmëri në përbushjen e misionit të shenjtë për një Shqipëri europiane të lirisë, dinjitetit dhe demokracisë! Gëzuar!".

META URON 28-VJETORIN E "RD": JETË TË GJATË

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, uroi dje 28-vjetorin e themelimit të gazetës "Rilindja Demokratike". Njëpërmjet një statusi në "Facebook", kreu i shtetit i uron gazetës "jetë të gjatë". "Me rastin e 28-vjetorit të gazetës së parë opozitare 'Rilindja Demokratike', i uroj stafit, të gjithë gazetarëve dhe drejtuesve të saj në vite, shumë suksese të mëtejshme! Gëzuar dhe jetë të gjatë RD!", shkruan Meta. Numri i parë i gazetës "Rilindja Demokratike" doli në 5 janar 1991.

SHKURT

LSI: Prisi, skandale të reja do dalin në dritë

LSI përmes deputetit Endrit Brahimllari paralajmëron publikimin e materialeve që demaskojnë qeverisjen. Në një intervistë për "Politika Online", ai shprehet se emri i Gent Cakajt, i zgjedhur nga kryeministri Edi Rama për ministër të Punëve të Jashtme konsiderohet provokim nga opozita. Sipas Brahimllarit, ky post kërkon figurë të lartë politike, që nuk reflektohet nga CV-ja e Cakajt. Sa i përket protestës së studentëve, Brahimllari shprehet i sigurt se në datën 7 janar do të rikthehet më e fuqishme. Kjo sipas tij, pasi VKM-të për uljen e tarifave të studimit janë mashtim, pasi ato nuk janë reflektuar me ndryshimin e buxhetit të shtetit.

Ruçi uron Engel: Jeni mbrojtës i Shqipërisë dhe Kosovës

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi uron zyrtarët e lartë të sapozgjedhur të Kongresit të SHBA, Eliot Engel, Steny Hoyer dhe James E. Risch. Ruçi i dërgoi dje një mesazh urimi z. Eliot Engel, me rastin e zgjedhjes kryetari i Komitetit të Çështjeve të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Populli shqiptar sheh në personalitetin Tuaj mbrojtësin më të spikatur të çështjeve të shqiptarëve të Shqipërisë dhe Kosovës për më shumë se tri dekada, merita për të cilat keni fituar mbështetjen e komunitetit shqiptaro-amerikan të Nju Jorkut. Si kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, shpreh besimin në bashkëpunimin tonë të ngushtë në të ardhmen", shkruan në mesazhin e tij, dërguar kryetarit të Komitetit të Çështjeve të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA, kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi. Mesazh të posaçëm kryetari i Kuvendit të Shqipërisë i dërgoi edhe Steny Hoyer, me rastin e zgjedhjes kryetar i Grupit Demokratik të Dhomës së Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe James E. Risch, me rastin e zgjedhjes kryetar i Komitetit të Marrëdhënieve të Jashtme të Senatit të SHBA.

Medar KAJOLLI Përmbraues Gjyqësor Privat me sell në Rr."Urani Pano" Pll.1/3, Kati-2, Tirane, nxjerr në shitje në ankan pasurite e paluajtshme si me posthe;

Passuria Nr. 1574, Vol.-32, fq.-207, Z.K-8210, lloji Njësi me Sip.-32 m2, Tiranë, me vlerë 3591'072 (Tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e dy) Lekë, në pronësi të debitorit Z.Besnik Binjaku. Shitja e pasurive të paluajtshme do të bëhet (zhvillohet) në datë 11.01.2019, ditën e Premte, ora 16.00 në Zyren e Përmbrauesit Gjyqësor Privat Z. Medar KAJOLLI, në Adresën RRuga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati-2, Tiranë.

Për informacione mund të kontaktoni
Nr.Tel.+355 66 20 333 03, ose në Adr.-email:medar.kajolli@gmail.com

Pas vrasjes, Gazmend Musta telefonoi të atin: Ma bëj hallall, takohemi në botën tjetër

Masakroi 28 herë me thikë gruan dhe kumatën 18-vjeçare, autori: Më ofenduan, s'durova më

"Jam penduar për krimin, tani kam vetëm hallin e fëmijëve"

TIRANË

Gruan e godita me thikë se më ofendoi, s'durova më. Jam penduar për krimin. Tani kam vetëm hallin e fëmijëve". Kështu ka deklaruar dje në Gjykatën e Krimeve të Rënda 34-vjeçari Gazmend Musta, i cili pasditën e 2 janarit masakroi me thikë e bukës bashkëshorten 31-vjeçare, Gentiana Çaushajn dhe kumatën 18 vjeçe, Merisa Çaushaj. Ngjarja e rëndë, e cila tronditi mbarë opinionin publik ndodhi në prani të dy fëmijëve të mitur të çiftit, në lagjen "5 Shkurti" të qytetit të Ballshit. Gjatë seancës së djeshme gjyqësore, prokuroria kërkoi masën e sigurisë "arrest me burg" për Mustën, kërkesë e cila u pranua nga gjykatësja Marsela Balili. Sipas organit të akuzës, shërrit mes çiftit Musta që përfundoi me dy viktima ka nisur kur 31-vjeçarja Genjana Çaushaj i kërkoi bashkëshortit që të shkonte për vizitë në familjen e prindërve të saj. Kjo kërkesë është kundërshtuar nga i shoqi, i cili në gjendje të dehur ka marrë thikën e bukës duke qëlluar disa herë Gentjanën dhe Melisën, duke i lënë të vdekurja në vend. Situatë është sqaruar me detaje edhe nga vetë autori i pyetur nga prokurorët.

"I dyshuari Gazmend Musta shpigoj në prani të mbrojtësit përpara prokurorit se vrasjen e bashkëshortes Gentiana dhe kumatës Merisa e bëri pasi atë pasdite gruaja Gentiana i kërkoi që bashkë me të motrën të shkonin të shtëpia e prindërve të saj në Drizar/Mallakastër. Ai nuk që dakord që ajo të shkonte atje, për këtë kanë debatuar me të madhe në familje, rreth orës 16:30, pas kësaj mori një thikë kuzhine dhe i qëlloi të dyja, aty ku gjendeshin në divan, kjo ndodhi në prani të dy fëmijëve", është shprehur përfaqësuesi i akuzës. Ndërkaq, autori i krimin të dyfishtë ka pasur vetëm një kërkesë; kujdesin për dy fëmijët e mitur 3 dhe 7-vjeç, të cilët deri në një vendim të gjykatës do të jenë në kujdestarinë e vjehrrës së tij. Musta do të mbrohet nga një avokat i caktuar nga shteti, Lauren Thomollari, ndërsa në gjykatë nuk ka pasur asnjë të afërm të tij. Në fund të seancës gjyqësore, trupit gjykues la në burg Gazmend Mustën, i cili rrezikon dënimin me burgim të përjetshëm.

NGJARJA
Debatit ka nisur gjatë drekës së 2 janarit, ku e ftuar ishte edhe 18-vjeçarja Merisa Çaushaj. Gentjana ka kërkuar që të shkojë për vizitë tek prindërit, të cilët jetonin në fshatin Drizar të Mallakastër, por ka ndeshur në kundërshtimin e bashkëshortit të saj. Pas debateve me bashkëshortin,



Viktima Gentiana Çaushaj me bashkëshortin dhe fëmijët



Gazmend Musta, dje në Gjykatën e Krimeve të Rënda

31-vjeçarja është shprehur se do të merrte fëmijët dhe do të shkonte vetë në fshat. Kjo gjë ka zemëruar së tepërmi Gazmendin, i cili është shprehur se ai ishte burri i shtëpisë dhe vendoste ai se çfarë do të bëhej. Fill pas shërrit, ai ka rrembyer thikën dhe ka goditur bashkëshorten, ndërsa motra e saj ka ndërhyrë për ta ndihmuar, por edhe ajo ka rënë pre e sulmit. Rreth orës 17:00, Gazmend Musta dhe dy fëmijët e tij të mitur mbërritën me makinën tip "Audi" përpara stacionit të policisë në Ballsh. Sa takoi efektivet e parë, ai iu tha se para pak çastesh kishte vrapë në banesën e tij bashkëshorten dhe kumatën. Me vete 34-vjeçari kishte edhe një thikë që e hodhi në tokë kur shkoi në polici. Ai u kërkoi policëve që të kujdeseshin për fëmijët e tij të mitur. Kur policia mbërriti në katin e 5 të një pallati në lagjen "5 Shkurti" në Ballsh, në dhomën e ndenjes në divan u gjetën trupat e pajetë të Gentianës dhe Merisës. Sipas policisë, tek të dyja u vërejtën plagë të shumta trupore dhe rrjedhje gjaku. Nga ekspertiza ka rezultuar se Musta e ka goditur gruan 11 herë me thikë, ndërsa kumatën e ka qëlluar 17 herë, madje këtë të fundit nuk ka nguruar ta bënte copa. Pas krimin, Musta ka telefonuar babain e tij, të cilit i ka treguar për ngjarjen. Sipas dëshmisë së familjarëve, mes çiftit Musta ka pasur konflikte edhe në të kaluarën. Babai i autorit të krimin të dyfishtë, Bedri Musta ka deklaruar se ditën e parë të Vitit të Ri, çiftit kishte qenë në fshat në banesën e tyre, ndërkohë që u shpreh se pikënisja e shërrit që përfundoi me dy viktima kishte qenë disa muaj më parë. Ai ka thënë para hetuesve të çështjes se Gentjana Çaush-

TELEFONATA PAS VRASJEVE
Bedri Musta, babai i 34-vjeçarit vrasës ka deklaruar në policinë e Fierit se kishte dënuar për ngjarjen pasi djalit, Gazmendin, e mori në telefon. Ai i kishte thënë se vrau të bashkëshorten dhe kumatën. "Ma bëj hallall, i vrava. Takohemi në botën tjetër bashkë". Gjithashtu, Bedri Musta është shprehur para hetuesve të çështjes, se Gentiana Çaushaj disa muaj më parë ishte larguar nga banesa për te familja e saj, por që më pas kishte shkuar te xhaxhai në Fier dhe nuk pranonte që të kthehej në shtëpi.

aj disa muaj më parë ishte larguar nga banesa për te familja e saj, por që më pas kishte shkuar te xhaxhai në Fier dhe nuk pranonte që të kthehej në shtëpi. Bedri

Musta ka sqaruar se pas ngulmimit të tij dhe djalit të tij, ajo ishte kthyer, ndërkohë që i kishin plotësuar edhe disa kërkesa, që ajo të ishte me e lirë dhe të kishte tele-

fon. Ndërkaq, vëllai i viktimate, Gjysmir Çaushaj ka deklaruar se autori nuk e linte motrën e tij që të dilte nga shtëpia, e fyente dhe e ofendonte.


EKSPERTIZA
Nga ekspertiza ka rezultuar se Gazmend Musta e ka goditur gruan 11 herë me thikë, ndërsa kumatën adoleshente, Merisa Çaushajn e ka qëlluar 17 herë. Madje këtë të fundit nuk ka nguruar ta bënte copa. Pas vrasjes së dyfishtë, 34-vjeçari është dorëzuar bashkë me armën e krimin në komisariatit e Mallakastër, ndërsa me vete kishte edhe 2 fëmijët e mitur (vajzën dhe djalin). Sipas dëshmisë së familjarëve, mes çiftit Musta ka pasur konflikte edhe në të kaluarën.

Plagosi me thikë bashkëshorten, kapet pas 9 muajsh 56-vjeçari

MALLAKASTËR - Policia e Ballshit ka ndaluar një shtetas të shpallur në kërkim për plagosjen me thikë të bashkëshortes së tij. Ngjarje kjo e ndodhur 9 muaj më parë. Sipas bluve, specialistët për hetimin e krimeve në Komisariatit e Policisë Mallakastër bënë kapjen dhe ndalimin e shtetasit të shpallur në kërkim B.Z., 56 vjeç, banues në Visokë, Mallakastër. Ndalimi i këtij shtetasi u bë pasi Gjykata e Shkallës së Parë Fier me vendimin e datës 16.11.2018 ka vendosur masën e sigurisë "Arrest në burg" për veprën penale "Plagosje e rëndë me dashje" parashikuar nga neni 88/2 i Kodit Penal. Shtetasi B.Z., në muajin mars 2018 për motive të dobëta ka plagosur me thikë bashkëshorten e tij, shtetase L.Z.

Përplasi për vdekje me makinë italianin, 24-vjeçarja shqiptare: Donte të më përdhunonte

ITALI - Edhe pas marrjes së përgjegjësisë nga 24-vjeçarja Aurela Perhati, vrasja e 53-vjeçarit Massimo Garitta mbetet ende në rrethana të paqarta plotësisht. Pse e reja shqiptare duhet të merrte në makinë një njeri të panjohur si lypës e përdorues droge, është pyetja që ngrenë autoritetet italiane edhe pas dëshmisë së Aurelës. Avokati i vajzës, Luca Amerio, në një intervistë radiofonike ka sqaruar versionin e dhënë nga 24-vjeçarja kur është marrë në pyetje. "Ishte një ngjarje tragjike dhe fatkeqe. Perhati është shprehur se çdo gjë e bëri për t'iu shmangur tentativës për dhunë seksuale. Ishte vetë ajo që ia sqaroi hetuesve se Garitta i kishte panta-



24-vjeçarja Aurela Perhati

llonat e ulura. Dhe ky është një element i rëndë që askush s'e ka përmendur, por që në fakt e ka tronditur vajzën. Aurela ka deklaruar se ka mundur të dalë nga makina bashkë me të. Dhe kur e pa veten në një pozitë më të mirë se sa viktima, ajo i ka dhënë makinës shpejt për t'u larguar, por ndërkohë ishte e rrëzuar dhe e ka përplasur atë pasi nuk e ka parë", tre-

gon avokati. Dhe për sa u përket dyshimeve të policisë që pse Aurela e hipi në makinë, është sepse Garitta fillimisht i kishte kërkuar që t'i bënte vetëm një xhiro dhe i kërkoi monedha dhe duhan. Ngjarja e rëndë ndodhi natën e ndërrimit të viteve, ku 24-vjeçarja shqiptare Perhati akuzohet për vrasjen e 53-vjeçarit italian.

Ngjarja në Korfuz e paralajmëruar, 1 vit më parë viktimia kishte denoncuar babain

U vra dhe u gropos nga i ati, i dashuri afgan: Ja dy telefonatat e fundit me Angjelinën

Zbardhet dëshmia e të riut: Biseda e fundit zgjati 26 sekonda, babë e bij po konfliktoheshin

GREQI

Pak ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në Korfuz, ku e reja shqiptare Angjelina Petro u masakrua me shufër hekur nga i ati, mediat greke kanë zbardhur dëshminë dhënë në polici të të dashurit afgan të viktimës. Ai ka treguar bisedën e fundit që ka bërë me 29-vjeçaren, e cila u vra dhe u gropos nga babai i saj, Aleko Petro. Ndërkaq, i është marrë dëshmi edhe babait të tij adoptues, i cili ka deklaruar se i ati i vajzës nuk e kishte pranuar kurrë lidhjen e dy të rinjve. Sipas mediave të vendit fqinj, i riut afgan ka pohuar në polici se me Angjelinën ka qenë në lidhje dashurie prej 13 muajsh. Mësohet se Angjelina donte të shkonte të vizitonte babain e saj për shkak të festave. Ndërsa i dashuri i saj nuk ishte dakord që ajo të shkonte, pasi nuk kishte raporte të mira me të atin. Në orën 20:45 i dashuri afgan kontaktoi 29-vjeçaren për t'u siguruar që kishte mbërritur te banesa e babait të saj. Kjo ishte telefonata e parë që mesa duket revoltoi Aleko Petron dhe nxiti debatin mes tyre, pasi 52-vjeçari ishte kundër lidhjes së vajzës së tij me emigrantin afgan. Në orën 21:23, i dashuri telefonoi përsëri Angjelinën. Biseda mes tyre zgjati 26 sekonda. E pyeti si po kalonte, kurse 29-vjeçarja shqiptare i tha se ndodhej në shtëpinë e babait, ndërsa nga zhurmat në sfond kuptoi që Angjelina po ngjiste disa shkallë. Më pas vajza shqiptare i kërkoi të dashurit që të mbyllte telefonin, pasi po i bërtiste babai i saj, Aleko. Vajza u dëgjua duke i thënë të atit: "Eshhtë e ndaluar që t'i flas edhe në telefon". Më pas, linja u mbyll. I dashuri afgan ka deklaruar gjithashtu gjatë marrjes në pyetje në polici se me Angjelinën kishin rënë dakord që pasi të largohet nga banesa e të atit, të takoheshin në një vend të caktuar, por nuk mbërriti kurrë në atë destinacion. Debati mes Alekos dhe vajzës së tij Angjelina ishte ndezur. Ai kishte goditur vazhdimisht me shufër hekur vajzën e tij. Kjo e fundit tentoi të largohet duke dalë nga një derë, por 52-vjeçari e ndoqi dhe e goditi të paktën 7 herë në kokë me shufrën e hekurit, duke i shkaktonur vdekjen. Më pas, trupin e saj e varrosi në oborrin e pasmë të shtëpisë së tij. Gjithashtu, mediat greke kanë bërë me dije se një vit më parë ka pasur një incident mes Angjelina Petros e babait dhe se rasti është denoncuar në polici. Mësohet se kallëzimi është bërë në janarin e vitit që sh-

MJEKJA LIGJORE

"29-vjeçarja është goditur të paktën 7 herë në kokë me shufrën e hekurit. Nga këto goditje vihet re tension, urrejtje. Duket se viktimia ka ngritur duart për të mbrojtur fytyrën, vazhonte ta qëllonte edhe në duar. Pastaj ky prind pastroi shtëpinë nga gjakrat, fshahu sendet personale dhe e varrosi në kopsht. Si mundet një prind të jetë kaq gjakftohët para një akti të tillë? Kjo vrasje më ka lënë pa fjalë, nuk ishte thjesht një incident, ishte shumë e egër, shumë brutale", ka thënë mjekja ligjore, Hrisavjgi Kushi për median greke.



Viktima Angjelina Petro

DENONCIMI

Mediat greke kanë bërë me dije se një vit më parë ka pasur një incident mes Angjelina Petros e babait dhe se rasti është denoncuar në polici. Kallëzimi është bërë në janarin e vitit që shkoi, kur Aleko Petro kishte shkuar në shkollën profesionale ku studioje vajza e tij dhe kishte tentuar ta merrte me forcë. Sipas tij, në dijeni për ngjarjen ishte drejtori i shkollës, i cili e referoi rastin tek një punonjës social e më pas çështja i kaloi policisë. Gjithçka u mbyll mes palëve me premtimin e të atit se situata të tilla nuk do të përsëriteshin.

koj, kur Aleko Petro kishte shkuar në shkollën profesionale ku studioje vajza e tij dhe kishte tentuar ta merrte me forcë. "Ai donte ta merrte në makinë dhe të largohej. Vajza kundërshtoi dhe nuk ra dakord", ka treguar avokati i Aleko Petros. Sipas tij, në dijeni për ngjarjen ishte drejtori i shkollës, i cili e referoi rastin tek një punonjës social e më pas çështja i kaloi policisë. Gjithçka u mbyll mes palëve me premtimin e të atit se situata të tilla nuk do të përsëriteshin. Pas ngjarjes së rëndë të ndodhur mbremënjë e 2 janarit, gjykata greke në Korfuz ka lënë në burg shqiptarin Aleko Petro, të akuzuar për vrasjen e vajzës së tij, Angjelina Petro. Seanca gjyqësore zgjati rreth dy orë dhe i pranishëm ka qenë edhe një avokat i autorizuar nga mamaja e viktimës, ish-bashkëshortja e Aleko Petros. Avokati mbrojtës i 52-vjeçarit ka kërkuar që klienti i tij të kryejë një ekspertizë të shëndetit mendor duke argumentuar se Aleko Petro mund ta ketë kryer krimin nën kush të rënduara psikologjike. I pandehuri pranoi krimin para hetuesve. Me kërkesë të prokurorisë, trupa gjyqësore e Aleko Petron në burg deri në përfundim të hetimeve.

Moti i keq, shënohet viktimia e parë në Ravonik të Korçës

Acari "pushton" vendin nga veriu në jug, ARRSH: Ja rrugët ku nuk do lejohet qarkullimi pa zinxhirë

Reshjet e dëborës si dhe Rtemperaturat e ulëta kanë shkaktonur probleme në disa zona të vendit. Si pasojë e motit të keq, mijëra banorë janë bllokuar që prej disa ditësh në Kukës, Dibër, Bulqizë, Krujë, Gramsh, Tepelenë dhe Korçë. Ndërkaq, ditën e djeshme është shënuar dhe viktimia e parë nga i ftohti në Korçë. Bëhet fjalë për 58-vjeçarin Jani Poda, i cili ka qenë duke lëvizur me biçikletë në rrugën e fshatit Ravonik. Dyshohet se 58-vjeçari ka pësuar atak kardiak nga i ftohti. Ndërkaq, Autoriteti Rrugor Shqiptar njoftoi dje se nuk do të lejohet qarkullimi i mjeteve pa zinxhirë në disa rrugë të vendit, për shkak të situatës së krijuar nga reshjet e dëborës. Sipas ARRSH-së, në rajonin verior në Shkodër nuk ka pasur reshje gjatë natës, temperaturat shumë të ulëta, të cilat kanë shkaktonur prezencën e akullit në rrugë. Kontraktorët e mirëmbajtjes kanë punuar gjatë gjithë ditës dhe janë

ende duke punuar për pastrimin e akeseve dhe shpërndarjen e kripës. Në akset rrugore Pukë-Pushë Arrëz, Kuben-Vasie, Burrel-Peshkopi, Skuraj-Burrel është bërë pastrimi dhe shpërndarja e kripës dhe qarkullimi është pa probleme. Pa probleme qarkullohet edhe në aksin Shkodër-Hani i Hotit-Tamarë. Lëvizja e mjeteve duhet të kryhet me zinxhirë në pjesën fundore të aksit Ura e Cerencit-Steblevë. Drejtuesit e mjeteve të vendosin zinxhirë në orët e para të mëngjesit në akset Qafë Buallit-Krastë, Kukës-Ura e Zapodit dhe Kukës-Bushtricë, për shkak të prezencës së ngricave në rrugë.

Në rajonin qendror Tiranë: Në akset e Dajtit, sidomos në pjesët fundore të tyre, është punuar për shpërndarjen e kripës dhe



pastrim e rrugës nga dëborë. Në të gjitha akset kalohet pa zinxhir. Në aksin Librazhd-Steblevë, në segmentin Lunik-Stebleve qarkullimi rekomandohet të kryhet me zinxhirë. Në aksin Elbasan-Gjinar nuk ka probleme për qarkullimin. Në aksin Librazhd-Përrenjas-Qafë Thanë është punuar për pastrimin dhe qarkullimi kryhet pa zinxhir. Në rajonin jugor Gjirokastrë: Gjatë natës nuk

ka pasur reshje dëborë, por temperaturat vazhdojnë të jenë shumë të ulëta. Është punuar në orët e para të mëngjesit për shpërndarjen e kripës dhe pastrimin e kaseve. Aksit kryesor Qafë-Thanë-Pogradec-Korçë-Bilisht-Kapshticë qarkullohet pa zinxhir. Korçë-Voskopojë qarkullohet pa zinxhir. Qarkullimi kryhet me zinxhir në Boboshticë-Dardhë, Qafë Qarri-Ersekë, Liqenas-Doganë Goricë. Me zinxhir qarkullohet në pjesën fundore të segmentit Erind-Çajup, si dhe në segmentin Sevaster-Kalivaç. Në segmentin Ura e Leklit-Përmet është punuar për shpërndarjen e kripës në vendet ku ka ngrica. Është punuar për pastrimin dhe shpërndarjen e kripës edhe në aksin Tepelenë-Dorëz-Peshkopi. Qarkullimi kryhet me kujdes.

Njoftim për shitje me ankand të tretë
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në mesin 568,577 e vjeltes te K.Pt.C do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e pales debitore B Kamberaj dhe L Kamberaj, Pasuria që shitet në ankand përbehet nga:
"Truall + Godine", me numër pasurie 14/283 ndodhur në Lagjen 10 Korriku dhe e regjistruar pranë ZVRPP. Vitorë, e ndodhur në Z K Nr:8602, volumi 35, faqe 144, me sipërfaqe truall 300 m2, sipërfaqe e kaltër përdehe 117,9 m2. Ankandi i tretë fillon me çmimin fillestar në masën 5.644.800 Lekë
Ankandi qendron i hapur 30 dite dhe do të zhvillohet në datë 23.01.2019 në orën 15:00 në Bulevardi "Gj.Fisho" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5.Tiranë. Ofertuesit duhet të tërheqin dokumentacionin si dhe të kontaktojnë tel. 67 20 82 543 e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com ose WEB www.powerjustice.al.com.

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbareus gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 21.01.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shlitjen e pasurisë së palajushme. Arë me nr. 179/87, vol. fq. 19 zK. 2326, në Kuman. Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramizi, me vlerë fillestare në ankand 420,0004(Katerqind e njezet mijë)LEKË.
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
ZYRA PERBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'
A. PASURIA nr. 281 / 10, e lloji "Arë", zona kadastrale 2631, volumi 18, faqe 15, sipërfaqe 1.000 m2, adresë: Mbroje-Korçë, në pronësi të KOÇO LENA. Çmimi 2.168.144 Lekë.
B. PASURIA nr. 187 / 20, e lloji "Arë", zona kadastrale 2631, volumi 11, faqe 250, sipërfaqe 1.500 m2, adresë: Mbroje-Korçë, në pronësi të KOÇO LENA. Çmimi 738.140 Lekë.
Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.01.2019.
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Aborti u bë i ligjshëm në Shqipëri në dhjetor të 1995-ës dhe sipas të dhënave të ISHP, vetëm në 5 vitet e fundit ka pasur më shumë se 29 mijë të tilla

29 mijë aborte në 5 vjet në Shqipëri, si po e ndikojnë ekonominë në vend

Nga Deada Hyka

Një nga efektet më të mëdha të legalizimit të abortit është rënia e nivelit të fertilitetit, si dhe e popullatës. Ky trend botëror po vihet re edhe në vendin tonë. Aborti u bë i ligjshëm në Shqipëri në dhjetor të vitit 1995, ndërsa sipas të dhënave të raportit tëurvejimit të Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), vetëm në 5 vitet e fundit ka pasur mbi 29 mijë aborte në të gjithë vendin. Sipas ekspertëve, legalizimi i abortit ndryshon modelin familjar: më pak fëmijë rriten në familjet me një prind, më pak fëmijë rriten në qendra sociale dhe më pak në varfëri. Ndërsa abortet mendohet se rrisin nivelin e mirëqenies për fëmijët e lindur, nga ana tjetër, ata gjithashtu heqin barrën nga tatimpaguesi. Pohimi se duke eliminuar një popullsi përmes abortit, sjell më pak shpenzime për ushqim, veshje dhe rritje për to, injoron faktin se në këtë mënyrë shkatërron një popullsi që do të ishte në të ardhmenë më pak konsumatore të produkteve të konsumit të mallrave për ta, si dhe në tkurrjen e popullatës dhe si pasojë, të fuqisë punëtore dhe numrit të taksapaguesve për një shtet. Por, ka edhe një anë tjetër medaljeje. Aborti shpeshherë shihet si zgjidhje ekonomike për familjet në vështirësi ekonomike, sidomos në rastin e grave të papuna dhe të pasiguruar.

RAPORTI I ABORTIT* SIPAS RAJONEVE NË SHQIPËRI, 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Shqipëria	186	165	180	170	171
Berat	245	205	149	195	231
Dibër	133	130	154	181	134
Durrës	133	146	154	152	139
Elbasan	61	75	91	71	55
Fier	225	191	194	173	193
Gjirokastrë	118	96	165	187	200
Korçë	116	126	99	110	110
Kukës	62	51	46	49	54
Lezhë	104	149	142	88	167
Shkodër	109	76	101	137	136
Tiranë	291	223	265	228	226
Vlorë	280	334	291	311	274

Burimi: Anketat e Sistemit të Surveajancës 2017, ISHP
* Numri i aborteve për 1000 lindje të gjalla


suar disa ndryshime ndër vite dhe aborti padyshim ka qenë një levë e ndryshimit demografik dhe njëkohësisht e tjetërsimit të familjeve.

Sipas tij:

1. Lindjet stimulojnë ekonominë. Prindërit blejnë sendet e nevojshme për to, duke qarkulluar para. Në këtë logjikë, më pak fëmijë nënkupton që bëhen dhe shiten pak produkte.

2. Një fëmijë i lindur sot është një punonjës shqiptar në të ardhmen, që do të thotë thotë kontribut në ekonominë e përgjithshme. Foshnjat rriten jo vetëm për të punuar, por edhe për të paguar taksa. Pak njerëz nënkupton më pak kontribute tatimore. Një shembull, shtypi i lirë i Kanadasë e përshkruan abortin e legalizuar si një "holokaust financiar" në SHBA. Legalizimi i abortit, ndikimi financiar i atyre amerikanëve që nuk punojnë ose kontribuojnë në shoqëri mund të kenë kushtuar më shumë se 27 trilionë dollarë në të ardhurat e humbura tatimore.

3. Një studim i aborteve të ndaluar në Rumani që filluan në vitet 1960 kishte rezultate kontroverze. Fëmijët e lindur menjëherë pas ndalimit të planifikimit familjar kishin shkollim më të mirë dhe më shumë sukses në vendin e punës, sipas studimit të Universitetit Columbia. Por ndalimi i aborteve njëkohësisht ndikoi ndjeshëm në rritjen e familjeve më të varfra, ku fëmijët kishin rezultate më të këqija arsimore dhe të



trekut të punës.

4. Përkrashtesë e jetës zakonisht theksojnë se fëmijët që nuk lindën, mund të kishin pasur role të rëndësishme në mjekësi, shkencë, biznes, art etj. Ndonëse, sigurisht ka edhe mendime të anasjella.

5. Niveli i uljes së lindjeve, rënia e fertilitetit u ngarkon të rinjtë të së ardhmes një barrë më të madhe për të mbështetur moshën e vjetër. Një politikë lindjeje e Kinës e zbatuar në vitin 1979, me 1 fëmijë për familje, tani e ka vënë qeverinë e saj në vështirësi, me më pak punëtorë të rinj për të mbështetur një popullsi të plakur.

ABORTET SIPAS QARQEVË

Në 5 vitet e fundit, vihet re një ulje e ndjeshme e lindjeve, shoqëruar me ulje të numrit të aborteve, sipas INSTAT. Megjithatë, vitin e

shkruar shifrat tregojnë se raporti i abortit me lindjet është 1 me 5.8 të tilla. Raporti i abortit është tregues që ka pësuar rënie me 15% krahasuar me 2013-ën, por duhet të theksojmë se bëhet fjalë për aborte të regjistruara (ka edhe që nuk raportohen).

Rajonet me proporcionin më të lartë të abortit për vitin 2017 janë Vlorë (274), Berat (231) dhe më pas Tiranë (226). Rajonet me raportin më të ulët të abortit janë përkatësisht Kukësi dhe Elbasani, me 54 dhe 55 aborte për 1000 lindje të gjalla. Numri i aborteve, sipas INSTAT, jo domosdoshmërisht shkon paralel me numrin e lindjeve të gjalla. Ka qarqe si Gjirokastra dhe Vlorë, ku numri i lindjeve është relativisht i ulët, ndërsa raporti i abortit i lartë. Bazuar në të dhënat e Sistemit të Sur-

veajancës së Abortit, ISHP monitoron trendin e abortit në vite, numrin total të aborteve (në nivel kombëtar dhe sipas rajoneve), nivelin e abortit (numri i aborteve për 1000 femra të moshës 15-49 vjeç apo grupeve të tjera moshë-specifike) dhe proporcionin e abortit (numri i aborteve për 1000 lindje të gjalla).

Gjatë vitit 2017 janë regjistruar në total 5279 aborte, 117 raste më pak se në vitin 2016 (5396 aborte). Numri i skedave të ardhura në ISHP nga të gjithë qendrat raportuese është 4417, duke përfqësuar 83.7% raportime totale, ndërkohe që gjatë vitit 2016, përqindja e raportimit me skedë ka qenë 78.2%. Ndër qytetet me numrin më të lartë të aborteve pas Tiranës (2117) përmendim Fierin me 425 aborte, Durrësin me 402 dhe Beratën me 305 aborte. Vlen të përmendet që kemi një rritje të raportimit me skedë nga dy maternitetet e Tiranës (76.3% në vitin 2017), krahasuar me vitin 2016, ku përqindja e raportimit me skedë ka qenë 58.0%.

EKSPERTJA, NDIKIMI NË SHOQËRI

Prof. dr. Arjana Muçaj pohon për "Monitor" se aborti në Shqipëri është parë gjithmonë si një plagë e shoqërisë, sepse në vitet e komunizmit, ai ndalohej me ligj dhe mund të kryhej vetëm në rastet kur rrezikohet jeta e nënës. "Sot pas viteve '90 ndodh e kundërta, sepse ndryshimet në shoqërinë tonë të ekspozuara në ekonomi e gjetën gruan shqiptare të papunë dhe ende vazhdon që gratë të jenë numri më i madh i të papunëve. Sot aborti po përdoret edhe për të shpëtuar jetën e gruas, për të ruajtur shëndetin mendor dhe fizik, shpeshherë për shkak të një dhune të ushtruar, ose

në rastet e një komplikacioni me fetusin. Ashtu sikurse po përdoret edhe për shkak të preferencave gjinore. Legjislacioni ynë e ndalon ndërprerjen e shtatzënisë me bazë gjinore.

Në një shoqëri ku problemet ekonomike dhe sociale janë shumë të pranishme, kuptohet që ndonjëherë kjo nuk është një zgjedhje e lehtë për nënat që abortojnë. Shpesh, kushtet në të cilat ato jetojnë dhe pamundësia për një zhvillim më të mirë të mirërritjes së fëmijëve i bën të pashpresa për të ardhmen", - thotë prof. dr. Muçaj. Prof. dr. Muçaj shتون se, "planifikimi familjar në Shqipëri është i lidhur me kushtet dhe mundësitë që duan t'u krijojnë prindërit e rinj fëmijëve në ditët e sotme. Nuk bëhet fjalë për familjet me shumë anëtarë. Por, për familjet e vogla që zgjedhin të mbeten me një fëmijë, më qëllim investimin më të madh tek ana fëmijë", - thotë ajo. Nga ana tjetër, prof. Muçaj thotë se ulja e normës së fertilitetit është një ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në përzgjedhjen e gjinisë para lindjes. "Në lindjen e fëmijës së parë, gjinia nuk përbën problem, por në lindjen e dytë bëhet shumë e rëndësishme, sigurisht në varësi të zonave të vendit. Pra, në kompleks mund të themi se janë një sërë faktorësh që ndikojnë në një abort. Por a ka ndikime në shoqëri? Edhe ndikimet janë të shumfshita. Duke nisur nga aspekti emocional i nënës, që shpeshherë çon deri në depresion nga ndjenja e fajit dhe deri te ndryshimi i madhësisë së familjes në Shqipëri, me rënieën e fertilitetit", - thotë në fund prof. dr. Muçaj.

"Monito.al"

PENSIONET E PLEQËRISË NDRYSHIMET

Formula e llogaritjes, ISSh: Masa, e bazuar në vitet e punës me kontribute dhe pagën

Si do të ndryshojë mosha e daljes në pension nga janari i 2019-ës

Tabelat e plota të viteve për burrat dhe gratë

Prej janarit të vitit 2019, do të ketë ndryshime të moshës së daljes në pension për të gjithë individët që kanë minimumi 15 vite pune me kontribute. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot moshën e daljes në pension për 2019-ën si dhe 2020-ën. Aktualisht për vitin 2018-të, mosha e daljes në pension sipas nenit 43, për gratë është 60 vite e 8 muaj (rritet për çdo vit me 2 muaj deri në vitin 2056 që arrin në 67 vjeç). Ndërkohë sipas kësaj llogaritjeje, mosha e daljes në pension për gratë në 2019-ën do të jetë 60 vjeç e 10 muaj, ndërsa në 2020 do të jetë 61 vjeç. Ndërkohë, burrat duhet të kenë mbushur moshën 65 vjeç në mënyrë që të përfitojnë pagesën e pensionit të pleqërisë (mosha fillon rritet që nga viti 2033 me nga 1 muaj në vit për të aritur në 67 vjeç në vitin 2056). Në bazë të reformës së vitit 2014-të, masa e përllogaritjes së pensionit varet nga vitet e punës dhe paga, pra pensioni është produkt i viteve të sigurimit dhe pagës mbi të cilin janë paguar kontributet. Sa më shumë vite të ketë aplikanti dhe sa më e lartë të ketë qenë paga e tij, aq më e lartë do të jetë masa e përfitimit. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se vjetërsia e plotë kontributive për të dy gjinitë është 35 vite e 8 muaj, e cila rritet me 4 muaj në vit, për të aritur me 40 vite në vitin 2029. "Personat e siguruar që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të këtij ligji", theksohet në ligjin "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për sa i përket pensionit të pleqërisë në vendin tonë. Ndërkohë personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension të përcaktuar në nenin 92 kur kanë plotësuar vitet e sigurimit sipas nenit 92; apo nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar. Ndërkaq, nënat që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë të rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim. "Për të lindur e drejta për pension pleqërie, kërkohen dy kushte, që janë vjetërsia kontributive jo më pak se 15 vite kontributive dhe mosha, që për-

PËR BURRAT						
Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
01.07.2010 - 30.06.2011	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	59	33	64v 6m	35	65v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	60	34	65v	35	65v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	60v 6m	35	65v	35v	65v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	61v	35v 4m	65v	35v 4m	65v	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	65v	35v 8m

01.01.2017 - 31.12.2017	62v	36v	65v	36v	65v	36v
01.01.2018 - 31.12.2018	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	65v	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	63v	36v 8m	65v	36v 8m	65v	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	63v 6m	37v	65v	37v	65v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	64v	37v 4m	65v	37v 4m	65v	37v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	64v 6m	37v 8m	65v	37v 8m	65v	37v 8m
01.01.2023 - 31.12.2023	65v	38v	65v	38v	65v	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	65v	38v 4m	65v	38v 4m	65v	38v 4m
01.01.2025 - 31.12.2025	65v	38v 8m	65v	38v 8m	65v	38v 8m
01.01.2026 - 31.12.2026	65v	39v	65v	39v	65v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	65v	39v 4m	65v	39v 4m	65v	39v 4m
01.01.2028 - 31.12.2028	65v	39v 8m	65v	39v 8m	65v	39v 8m
01.01.2029 - 31.12.2029	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2033 - 31.12.2033	65v 1m	40v	65v 1m	40v	65v 1m	40v
01.01.2034 - 31.12.2034	65v 2m	40v	65v 2m	40v	65v 2m	40v
01.01.2035 - 31.12.2035	65v 3m	40v	65v 3m	40v	65v 3m	40v
01.01.2036 - 31.12.2036	65v 4m	40v	65v 4m	40v	65v 4m	40v
01.01.2037 - 31.12.2037	65v 5m	40v	65v 5m	40v	65v 5m	40v
01.01.2038 - 31.12.2038	65v 6m	40v	65v 6m	40v	65v 6m	40v
01.01.2039 - 31.12.2039	65v 7m	40v	65v 7m	40v	65v 7m	40v

ca kthohet sipas tabelës së paraqitur në nenin 43 të ligjit (që ndryshon nenin 92).

FORMULA E LLOGARITJES

Për llogaritjen e pensionit të pleqërisë sipas ligjit 104/2014, neni 18, i cili ndryshon nenin 32 të ligjit 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Sh-

qipërisë" përcaktohet si më poshtë: Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Ndërkohë shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social. Ndërsa shtesa do të jetë 1 për qind për vit sig-

urimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 31 të ligjit 104/2014 (i cili ndryshon nenin 59 të ligjit 7703 datë 11.05.1993). Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social. Kjo e fundit bën me dije për të gjithë të intere-

suarit se për ta patur sa më të qartë këtë përlllogaritje, është e nevojshme të dihet se çfarë përfaqëson pensioni social. Ndërkohë, sipas ligjit 104/2014, pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kush-



vet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social. Masa e këtij pensioni social është e barabartë me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë me 15 vite të siguruar me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014. Ndërsa masa e pensionit social për personat që kanë të ardhura nga burime të tjera, do të jetë sa diferenca e pensionit social me të ardhurat e tjera që ka përfituesi. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pensionin social përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për llogaritjen e pensionit përdoret formula: PP (Pensioni i pleqërisë) = PS (Pension Social) * (shumëzuar) vjetërsi kontributive të realizuara / vjetërsi kontributive që kërkohet +1/100* (shumëzuar) vite sigurimi* (shumëzuar) BV (baza e vlerësuar)

BAZA E VLERËSUAR

Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data



KUSHTET
Të gjithë ata persona që kanë plotësuar moshën dhe kanë minimumi 15 vite pune me kontribute mund të përfitojnë pension pleqërie. Përkatësisht burrat duhet të jenë mbi 65 vjeç, ndërsa gratë mbi 60 vjeç e 8 muaj në mënyrë që të mund të marrin këtë lloj pagese.

1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish-punonjësit e institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994. Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës

ose funksionit përpara datës 01.01.1994 si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koefficientet e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Koefficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8,59.

SHENBUJ KONKRETE

Për ta konkretizuar këtë problem po të marrim një pagë referuese për një specialist të lartë në ndërmarrje ekonomike, që aktualisht është e miratohet në masën 4.192 lekë, duke e shumëzuar me koefficientin 8,59, e indeksuar deri në periudhën aktuale jep një pagë prej 36.009 lekë. Ndërsa mbas vitit 1994, merren pagat respektive sipas viteve, të cilat duke u shumëzuar me koefficientet përkatës, japin pagën për efekt të llogaritjes së pensionit. Po të marrim një

b) PËR GRATË

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
01.07.2011 - 30.06.2012	54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	54	33	59v 6m	35	60v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	55	34	60v	35	60v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	55v 6m	35	60v	35	60v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	56v	35	60v 2m	35v4m	60v2m	35v4m
01.01.2016 - 31.12.2016	56v 6m	35	60v4m	35v8m	60v4m	35v8m
01.01.2017 -	57v	35	60v6m	36v	60v6m	36v

30.12.2017						
01.01.2018 - 30.06.2018	57v 6m	35	60v8m	36v4m	60v8m	36v4m
01.01.2019 - 31.12.2019	58v	35	60v10m	36v8m	60v10m	36v8m
01.01.2020 - 31.12.2020	58v 6m	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	59v	35	61v2m	37v4m	61v2m	37v4m
01.01.2022 - 31.12.2022	59v 6m	35	61v4m	37v8m	61v4m	37v8m
01.01.2023 - 31.12.2023	60v	35	61v6m	38v	61v6m	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	60v4m	35v6m	61v8m	38v4m	61v8m	38v4m
01.01.2025 - 31.12.2025	60v8m	36v	61v10m	38v8m	61v10m	38v8m
01.01.2026 - 31.12.2026	61v	36v6m	62v	39v	62v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	61v4m	37v	62v2m	39v4m	62v2m	39v4m
01.01.2028 - 31.12.2028	61v8m	37v6m	62v4m	39v8m	62v4m	39v8m
01.01.2029 - 31.12.2029	62v	38v	62v6m	40v	62v6m	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	62v4m	38v6m	62v8m	40v	62v8m	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	62v8m	39v	62v10m	40v	62v10m	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2033 - 31.12.2033	63v 2m	40v	63v 2m	40v	63v 2m	40v
01.01.2034 - 31.12.2034	63v 4m	40v	63v 4m	40v	63v 4m	40v
01.01.2035 - 31.12.2035	63v 6m	40v	63v 6m	40v	63v 6m	40v
01.01.2036 - 31.12.2036	63v 8m	40v	63v 8m	40v	63v 8m	40v
01.01.2037 - 31.12.2037	63v10m	40v	63v10m	40v	63v10m	40v
01.01.2038 - 31.12.2038	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2039 - 31.12.2039	64v2m	40v	64v2m	40v	64v2m	40v
01.01.2040 - 31.12.2040	64v4m	40v	64v4m	40v	64v4m	40v
01.01.2041 - 31.12.2041	64v6m	40v	64v6m	40v	64v6m	40v
01.01.2042 - 31.12.2042	64v8m	40v	64v8m	40v	64v8m	40v
01.01.2043 - 31.12.2043	64v10m	40v	64v10m	40v	64v10m	40v
01.01.2044 - 31.12.2044	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2045 - 31.12.2045	65v2m	40v	65v2m	40v	65v2m	40v
01.01.2046 - 31.12.2046	65v4m	40v	65v4m	40v	65v4m	40v
01.01.2047 - 31.12.2047	65v6m	40v	65v6m	40v	65v6m	40v
01.01.2048 - 31.12.2048	65v8m	40v	65v8m	40v	65v8m	40v
01.01.2049 - 31.12.2049	65v10m	40v	65v10m	40v	65v10m	40v
01.01.2050 - 31.12.2050	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2051 - 31.12.2051	66v2m	40v	66v2m	40v	66v2m	40v
01.01.2052 - 31.12.2052	66v4m	40v	66v4m	40v	66v4m	40v
01.01.2053 - 31.12.2053	66v6m	40v	66v6m	40v	66v6m	40v
01.01.2054 - 31.12.2054	66v8m	40v	66v8m	40v	66v8m	40v
01.01.2055 - 31.12.2055	66v10m	40v	66v10m	40v	66v10m	40v
01.01.2056 - 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

rast konkret; në vitin 2008, paga minimale ka qenë 14 830 lekë, duke u shumëzuar me koefficientin e indeksimit (i cili miratohet çdo vit me VKM), që është 1,48 jep pagën minimale prej 22.000 lekë. Po kështu dhe paga maksimale e cila ka qenë 74.150, kur shumëzohet me po këtë koefficient indeksimi jep pagën maksimale aktuale 97.030. Sigurisht pagat e ndërmjetme, me indeksimin sipas koefficientëve përkatës, do të na japin paga aktuale ndërmjet minimale e maksimales. Në rast se marrim në mënyrë hipotetike që një punonjësit para vitit 1994 ka një vjetërsi kontributive prej 15 vitesh dhe paga mesatare e indeksuar rezultojn në një shumë prej 25 000 lekë dhe mbas vitit 1994 ka një vjetërsi kontributive prej 22 vite me një pagë mesatare të indeksuar prej 30 000 lekësh, atëherë baza e vlerësuar do të llogaritet:

Baza e vlerësuar = (15*25.000 lekë + 22 * 30.000 lekë) : 37 (vite gjithsej) = 28.000 lekë. Pensioni mujor = (6.750 *37/35,7) + (1/100 *37*28.000) = 6.996 + 10.360 = 17.356 lekë. Sipas nenit 33 të ligjit 104/2014, i siguruarit, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie sipas nenit 43 të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,5 përqind të pensionit për çdo muaj që shtyn datën e daljes në pension dhe vazhdon të paguajë kontribute. Përfituesi i pensionit të plotësisë, që ndërpret pensionin, vazhdon të punojë dhe paguan kontribute, merr shtesë mbi pension në masën 0,5 për qind për çdo muaj ndërprerjeje. Kjo shtesë llogaritet mbi atë mesatare që rezultojn pas rritjeve dhe indeksimit që ka pësuar pensioni gjatë kohës së ndërprerjes. Në rastin e mësipërm, në qoftë se ky person ka punuar mbi moshë për një periudhë prej 1 viti e 6 muaj, shtesa mbi

pension do të llogaritet, 18 muaj * 0,5 = 9% * 17.356 = 1.562 lekë. Në këto kushte pensioni që do të përfitonte aplikuesi do të ishte i barabartë me shumën: 17.356 + 1.562 = 18.918 lekë.

KOEFIKIENTI E INDEKSIMIT

Koefficientet e indeksimit janë ata koefficientë që kërkojnë që pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra ti heqin efektin "gërryes" të inflacionit. Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar në 94-ën, me gjithë indekset e ndryshimit që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë, indeksohet sot me një koefficient 8,59. Pra ajo pagë mësuesi që ka qenë 7 mijë lekë të vjetra, po ta aktualizojmë sot del 360 mijë lekë të vjetra. Edhe ky indeks sot është i përshtatshëm, e fillojnë nga 94' deri në momentin që

del në pension. Viti 2018 nuk ka indeks, kurse viti 2014, 2015 kanë koefficientet respektive. Ndërkohë pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicionin pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indeksohet e del vlerë më e lartë. Në këto kushte gjithë periudha ponderohet, e individit i del një pagë mesatare bazë e vlerësueshme, e cila shumëzohet me 40%, në rastet kur ka punuar 40 vite (1% për çdo vit pune). Pas kësaj del një vlerë së cilës i shtojmë edhe pensionin social dhe marrim vlerën përfundimtare të pensionit të pleqërisë. Nëse baza mesatare e vlerësuar del në vlerë më të madhe, po ashtu do të rezultojë edhe pensioni.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



ANALIZA

GABIMI FATAL I SHQIPËRISË

Pas një meshe për të vërtetën

Nga Visar Zhiti

FJALË PËR NJË FILLIM:

Një nga porosítë për këtë Vit të ri ç'mund të ishte? Se çdo fillim, jo vetëm i vitit, por dhe i një takimi, i një rruge apo epoke, i një jete, i një libri, i një elegjie a kënge, etj., etj., i duhet një shenjës, një ndjellje, se, siç ka një pikturë firmën në fund, ka dhe njollën e parë nistore apo filmi, kur mbaron e lexohet "The end", ka një titull në fillim.

Dhe s'ka pse të jetë një fillim i ngjashëm me fundin, nga nisi, pa varësisht vazhdimësisë. Gjithsesi do që të thuash diçka pararendëse, që të mos jetë vetëm për ty, por për sa më shumë... për njerëz e kohën. Drithmërisht e singërtë, që të shërbejë si një e vërtetë, si një përvojë. Le të jetë qortuese për të gjithë dhe askënd, t'i ngajë hapjes së një testamenti nga viti i shkuar, për një zbatim të ri, në mos, një denonimi për atë që s'duhet më, që e bën ende më lodhës atë që vazhdojmë ta quajmë "tranzicion", duhet një porosi për vazhdimin tjetër, le të jetë klithmë e vetmuar, rënkim plage, ngazëllim dhe qëndresë jona, shpresë, dorë që na tregon drejtimin.

Unë e zgjodha atë që do të doja të thosha, jo për vete, është si një dashuri, e dëshpëruar e pa dëshpëruar - dashuria është dashuri. Thjesht po sjell një zbulues për atë që s'ka qenë e mbuluar, që dihet, por nuk është përmbledhur as si një përfundim e as si një prirje udhe, s'është në ligj, mbase në përbesimet e fshehta, ngjan me kodet kafkiane, por gjendet thellë e më thellë. Më ndihmoi një meshe të gjej. Po ua them, është si një hakmarrje biblike ndaj vetvetëve tona, për të gjithë ata "që nuk e bëjnë historinë, por e pësojmë atë", jo, jo, shërben për të dy palët, për të gjithë si vetë mesha.

Heshtet për të ashtu siç heshtet për më të rëndësishmet, por dhe ishte folur siç flitet për rrezikun, nën zë, mbytur, por që befasisht shpërthen si me protestat, nën thirrje të tjera, por është po ajo.

Duket sikur do të nisë prapë siç nisi dikur, për dritat elektrike që ndërpriteshin në konviktet e studentëve, por fjala ishte për dritën e madhe, që sjell liria, manifestuan në fund të vitit që shkoi për përgjysmimin e tarifave të studimit, për kushtet etj., sa edhe Kryeministri i Vëndit u dha të drejtë, ndërkaq ajo duhet kuptuar si protestë kundër përgjysmimit të dëshirave, ëndrrave, lumturisë, të së vërtetës. E vërteta përgjysmë nuk është më e vërtetë... Kjo do njojnë e zanafillës, "pse-në" e saj.

Për këtë qëllim, në këtë fillimviti unë zgjodha një meshe, që e kam rrëfyer në një libër timin, "Si na



erdhi ai, i ndaluar", që, sipas meje dëshmon atë që na ishte ndaluar, shpirtëroren, hapur apo fshehurazi. Duket se flitet për një poet të njohur, "zyrtar", duke dashur të them se në një farë mënyre gjithkush është poet i jetës së vet. Është dhe një student, e ardhmja që kërkon prej nesh dhe na gjykon duke na dashur.

Por gjendja mund të ashpërsoset. Dhe shkaqet nuk janë të gjitha të tanishme. Çfarë u bë keq qysh në krye?

//

Heshtet për të ashtu siç heshtet për më të rëndësishmet, por dhe ishte folur siç flitet për rrezikun, nën zë, mbytur, por që befasisht shpërthen si me protestat, nën thirrje të tjera, por është po ajo.

TË PREKËSH PLAGËT

...Të gjithë jemi poetë e një perandorie të rënë, me poezi, pa poezi, mërmërita sërisht. Na ka zënë nën vetë dhe dalim nga gërmadhat të copërluar. Ca i nxjerrin të vdekur. Ndokush ka qenë i mbrojtur brenda ndonjë bunkerit a nën ndonjë kupolë. Në fund të fundit gjithkush ka ringjalljen e vet.

Edhe poezia është ringjallje... E në Shqipëri? pyes unë, një poet është më pak se një poet? Dhe shtova në heshtje: "Ai" është poeti i madh i një perandorie që ra, që natyrisht poezia nuk bie bashkë me perandoritë.

Mezi po prisnim të shkonim në kishën tonë... Donim të luteshim së bashku. Për djalin. Për ëndrrat e tij... edhe për të dashurit tanë, për miqtë e përbashkët... për vendin. Të ndizja dhe një qiri... Gjatë homelisë meshtari po na fliste për ringjalljen e Krishtit e për dëshimin e Tomës, nga që s'kishte qenë i pranishëm në atë ringjallje dhe donte të sigurohej në ishte i njëjtë ai që ishte kthyer nga vdekja me atë që kishin kryqëzuar... pa vënë gishtin tim në vendin e gozhdëve, pa e shtirë dorën time në kraharorin e tij, kurrë nuk besoj... shkruhet në Ungjillin sipas Gjonit.

Pa këtë vazhdimësi s'do të kishite kuptim... po thoshte meshtari. Ngrita kryet i trondituri si ai që zbulon një gjë me rëndësi. Tek ne kishte ndodhur ndryshe, nuk i

kishin prekur dhe aq plagët tona, s'na kishin vënë dorë në kraharor, nuk na besonin duke qenë dhe vetë të mosbesuar dhe më e rënda, të tjerë ishin ata që u kryqëzuan dhe të tjerë ishin ata që u ringjallën.

Gabimifatal që kishte bërë Shqipëria... Ia thashë sime shoqeje. Më pa dëshpërueshëm... Dhe shkuam shumë larg, në Washington. Mora me vete tragjedinë time, dhembjen, mëkatet që i dija dhe s'i dija. Atëheun. Dhe dëshirën e thellë për ringjallje. Jo timen, por dhe

//

Fjala ishte për dritën e madhe, që sjell liria, manifestuan në fund të vitit që shkoi për përgjysmimin e tarifave të studimit, për kushtet etj., sa edhe kryeministri u dha të drejtë

timen... Si është ajo dhe si ndodh?... është për të gjithë? Pasvdekja është një nga shqetësimet e përgjeshme të njeriut, besoj, edhe për jo besimtarët. Përtjetësia është dashuri, them, prandaj dhe dashuria mbetet e përgjeshme.

Që në ditët e para në Uashington kërkuam kishë. E gjetëm afër shtëpisë. Mesha në anglisht. The Lord be with you, tha meshtari dhe ne, të gjithë, u përgjigjëm: And with your spirit. Gjatë lutjeve, nën zërat që na mbulonin, unë mërmërisja në shqip, Ati ynë që je në qiell... At'joni im... Nodhte dhe që shkruaja.

Ishim të ulur nga fundi... Kur mesha mbaroi, në anë të ndenjësjes pashe një targëz metalike, e lexova, aty rrinte Presidenti John F. Kennedy, shih, shih, sa interesante dhe nuk shkonte në rreshtin e parë...

Ah, po, ai vinte këtu para se ta vrisnin, shtova këtë varg dhe po mendoja ringjalljen e tij, aq sa ia dilja, presidenciale, trashendental, e mistershme, qiellore pa tjetër, ndërsa unë kisha ardhur këtu pas vrasjes time, ia shtova dhe këtë poezisë, por s'e dija ç'ringjallje kisha pësuar apo thjeshtë atë tokësoren, të plagës time, të bërë tashmë më të madhe se sa unë.

T'I RIKTHEHEMI POROSISË.

E patë Presidentin e vendit më të pasur në botë, më të fuqishëm e më demokratik? Në tempull dhe ai si të gjithë, për të dëgjuar lutjet e njerëzve?

Librat e Shenjtë, mes të tjerash kanë dhe porosinë, që të lutemi dhe për armiqtë tanë, t'i kthejmë ata në vëllezër, t'i duam, edhe pse jetojmë në kohën e çvëllazërimit, të zhgënjimeve. Po humbet duhet të bëjmë që të kthehen në përvojë për mirë, korrupsioni të mos jetë motori që do të lëvizë dhe këtë vit, të rikthehen puna, të mirat e saj dhe ngazëllimi i tyre, gjithë arritjet të japin lumturinë e brendshme, begatinë e gjithanshme, paqen, nderin dhe moralin që duhet të jenë me të parat fare.

Pas gabimit fatal të Shqipërisë, si ai që ka arritur fundit, të ngjallim shpresat e ringritjes. Bashkëpunim, së pari me nesh, pastaj me të tjerët, aty ku aspirojmë, me botën e përpëruar EuraAtlantike. S'ka pse të pritë nga ndokush, të mos i besohet verbërisht disave, që nuk besojnë në ne, sidomos atyre që udhëhoqën "Gabimim fatal" dhe atyre që e vazhdojnë si një mashterim të madh, por ta kërkojmë nga vetvetet, që s'janë pak, është nuklea e të gjithës, e pafund, është popull, duke dashur të hapim edhe më Qiellin tonë, "për më shumë dritë", për më shumë dashuri. Të thirrret e ardhmja që të bëhet e tashme, por kujdes se përgjysma mund të jetë ashtu siç je(m)i sot...

Të bëhemi ashtu siç duam të jemi nesër. Me punë e mund e dashuri!


NGA FOTOQANDREA

Autori thekson se në aktivitet ka referuar dalimin midis poezisë gojore, tradicionale dhe tepër të pasur nga njëra anë dhe nga ana tjetër, poezisë së shkruar, të kultivuar apo "savante", sipas termit të përdorur nga prof. Alexandre Zotos në Antologjinë e tij "Poezia shqipe" me mbi 70 autorë (botuar më 1996). Vumë në dukje se është pikërisht poezia gojore ajo që përbën bazën themelore të vetë poezisë së shkruar, shtratin historik të saj...

Në datat 19-24 nëntor 2018, u mbajt në Strasburg, konsideruar si kryeqyteti i Europës, Takimi Botëror i Poezisë, organizuar nga Shoqata Mo-Zar (Mots-Arts), në bashkëpunim me Forumin Botëror të Demokracisë (Këshilli i Europës), me Bashkinë e Qytetit të Strasburgut si dhe me pjesëmarrje poetësh, shkrimtarësh e studiuesish nga pesë kontinente, nën drejtimin e një Komiteti shkencor përbërë nga profesorë universitetesh europiane, konferencierë, shkrimtarë, botues, doktorë në Letra, etj. dhe kryesuar nga Enrique Uribe, profesor në Universitetin e Strasburgut.

Në Takim, ndër poeteshat, poetët e studiuesit që morën pjesë nga mjaft vende - nga Franca, Portugalia, Spanja, Maroku, Cadi, Kanadja, Irani, Iraku, Belgjika, Rusia, Bullgaria, Rumania, Greqia, Venezuela, Kolumbia, Anglia, Shtetet e Bashkuara, Palestina, Peruja, Gjermania, Algjeria, etj. - merrte pjesë edhe autori i këtij shkrimi për të përfaqësuar Shqipërinë, ku mbajti kumtesën "Shqiptarët një popull poet" më datën 23 nëntor në Villa Schützenberger, si dhe prezantoi në mënyrë të veçantë dy poetë shqiptarë: poetin martir të demokracisë Havzi Nelën, dhe poetin Moikom Zeqo në Kinema Odysée më 24 nëntor 2018 me poezi që i kishim përkthyer posaçërisht për këtë ngjarje të shënuar.

Takimi botëror i Poezisë u udhëhoq nën moton "Poezi, çfarë ke për të na thënë?", ku poetë, studiues, botues, librarë, amatorë të poezisë, studentë e gjimnazistë që mbushën sallat për një javë rresht kishin shumë për të thënë në këtë periudhë të cilësuar



Një histori e përmbledhur e poezisë shqiptare në Francë

"Krizë e shoqërisë, Krizë e poezisë", përballë apatisë së masës njerëzore për mbrojtjen e demokracisë dhe paqes në botë, për kultivimin dhe ruajtjen e tyre nëpërmjet institucioneve demokratike dhe bashkim-it e bashkëpunimit mes popujve, duke kundërshtuar çdo fatalizëm,

çdo humbje besimi në regjimin demokratik dhe integrimin europian. Në Manifestin e miratuar në përfundim të veprimtarisë, titulluar: "Ruhu Europë, Europa për Europianët", u vu në dukje fuqimisht se poetët dhe poezia janë në gjendje të rigjallërojnë besimin në vlerat

demokratike, se pasioni poetik nuk është thjesht e vetëm në varg, por se atë e përjetojmë të gjithë përditë si qytetarë të këtij universi harmonik që na bashkon mrekullisht, dhe më në fund se poezia mbetet thelbësisht e pandashme nga vetë nocioni i lirisë e i besimit në shoqërinë njerë-

zore, themeli për ta mbajtur përherë gjallë këtë poezi, siç parashikonte poeti peruvian Cesar Vallejo që më 1937: "Europë, po të kujtojmë: "Ruhu për veten tënde!... Ruhu për të ardhmen...!"

→ Vizion në faqen 19

Në këtë numër: FOTOQ ANDREA, KRISTO KRISIKO, ALFRED MEHMETI, MK, YMER HYSA, GAZMEND ÇITAKU, ETJ..

A

AKTIVITET

NGA FOTQAQ ANDREA

Vijon nga faqja 1

Paraprakisht, në takim me kryetarin e shoqatës Mots-Arts Enriq Uribe Carreño, i paraqitëm Komitetit drejtues të aktivitetit një abstrakt të kumtesës sonë si dhe dymbëdhjetë poezi të përzgjedhura nga poetë shqiptarë, klasikë e të sotëm (në frëngjisht), nga N. Frashëri, Migjeni, Çajupi, L. Poradeci, D. Agolli, I. Kadare, F. Arapi, Xh. Spahiu, M. Ahmeti, M. Velo, P. Shllaku, D. Çomo. Kërkuam me këtë rast t'i bëhëj nderim i veçantë në Takim poetit martir shqiptar Havzi Nela (varur më 1988 nga regjimi komunist - dy vjet para shembjes së Murit të Berlinit), poezia e të cilit "Quand je mourrai" ("Kur të vdes"), së bashku me foton e tij të botoheshin në faqen web kushtuar kësaj ngjarjeje. Kjo kërkesë e jona u miratua menjëherë.

Në kumtesën tonë, për gati një orë e gjysmë, bëmë një historik të shkurtër të poezisë shqipe ndër shekuj, duke u ndalur konkretisht në tre etapa të zhvillimit të poezisë: asaj rilindëse, post rilindëse dhe poezisë së sotme, si dhe duke paraqitur pikëtakimet e poezisë shqipe me poezinë evropiane e posaçërisht me poezinë frënge. Vumë në dukje se që më 1847, Lamartin, i shkruante poetit arbëresh De Rada se "poezia ka ardhur nga brigjet tuaja dhe duhet të rikthehet atje". Po ashtu, në vitet '40 të shek. XX, një artikull në italisht për kombin shqiptar mbante si titull "Gli Albanesi, un popolo di poeti et di soldati". Më 1989, një personalitet i njohur francez Xavier Diniou, ish sekretar shteti dhe ish sekretar i përgjithshëm i asamblesë parlamentare të frankofonisë, në një shkrim kushtuar Shqipërisë, vinte në dukje: "Atdheu shqiptar... është krijuar nga poetët". Veç kësaj, Alain Bosquet dhe Michel Métais, që në vitet '70, duke prezantuar Kadarenë tek lexuesit francez, nxirrnin në pah shpirtin poetik ndër shekuj të popullit shqiptar dhe po në atë periudhë, dy poezi të Kadaresë do të figuronin për vite me radhë në një Antologji letrare për sistemin e shkollës së mesme franceze (kolegjet e gjimnazet).

Që në fillim, theksuam dallimin midis poezisë gojore, tradicionale dhe tepër të pasur nga njëra anë dhe nga ana tjetër, poezisë së shkruar, të kultivuar apo "savante", sipas termit të përdorur nga prof. Alexandre Zotos në Antologjinë e tij "Poezia shqipe" me mbi 70 autorë (botuar më 1996). Vumë në dukje se është pikërisht poezia gojore ajo që përbën bazën themeltare të vetë poezisë së shkruar, shtratin historik të saj. Tradita e fortë e poezisë gojore shqipe, së bashku me folklorin e pasur, njihet që në mesjetën e hershme dhe një libër për poezinë epike shqipe është botuar në Francë më 1968, titulluar "Chansonnier des preux albanais", (Eposi shqiptar i kreshnikëve), që përmban shumë vëllime në origjinal për këngët historike shqipe me zanafillë në shekujt XI-XII dhe që trajtojnë ngjarje të ardhjes së sllavëve në Ballkan në shekujt VI-VIII. Theksuam në këtë mes pikëtakime të eposit shqiptar me eposin frëng dhe se Këngët e Rolandit (eposi francez) përmbajnë disa strofa për kalimin e frankëve të Karlit të Madh në Shqipëri gjatë periudhës së Kryqëzatës së parë.

Nga ana tjetër, tërhoqëm vëmendjen se kjo poezi gojore është e pasur në zhanre të ndryshme, dhe arrin kulmin e vet me këngët polifonike të Jugut të Shqipërisë dhe këngët me lahutën monokorde të Veriut të Shqipërisë, për të cilat ka shkruar edhe Pros-

Takimi Botëror i Poezisë në Strasburg pak kohë më parë ka mbledhur një sërë studiuesish. Fjala interesante e autorit është pritur shumë mirë nga të pranishmit...

SHQIPTARËT, si ka ndikuar poezia për identitetin



per Merimé. Një lloj i tretë kënge krejtësisht të veçantë përbën korpusi i këngëve çame të Epirit të Veriut, apo të shqiptarëve të Greçisë, pa harruar këngët e shqiptarëve të Italisë (arbëreshëve), apo ato të shqiptarëve të Kosovës. Nëse kënga dhe poezia gojore janë tejet të zhvilluara historikisht në Shqipëri, kjo ndodh thjesht për faktin se gjuha e shkruar ishte e ndaluar gjatë pushtimit osman prej pesë shekujsh të vendit. Nga ku dhe rëndësia e poezisë gojore, e baladave, legjendave, këngëve epiko-historike, që jo vetëm përcelleshin lehtë me gojë nga brezi në brez për shekuj të tërë, por ishin edhe një përgjigje e drejtpërdrejtë e popullit ndaj pushtimit të egër osman, dhe kur populli i thjeshtë, për çdo ngjarje brenda fshatit, qytetit, krahinës, për çdo bir të tij martir, për çdo bëmë të lartë thurte menjëherë këngë për të pavdekësuar çastin epiko-historik e për të përjetësuar me lirizëm çdo gëzim e dashuri të njeriut shqiptar me jetën dhe natyrën. Në këtë kuptim, theksuam se poezia në Shqipëri është po aq e lashtë sa dhe vetë gjuha shqipe, një degë



Poezia gojore në Shqipëri

Poezia gojore është e pasur në zhanre të ndryshme dhe arrin kulmin e vet me këngët polifonike të Jugut të Shqipërisë dhe këngët me lahutën monokorde të Veriut të Shqipërisë, për të cilat ka shkruar edhe Prosper Merimé. Një lloj i tretë kënge krejtësisht të veçantë përbën korpusi i këngëve çame të Epirit të Veriut, apo të shqiptarëve të Greçisë, pa harruar këngët e shqiptarëve të Italisë (arbëreshëve), apo ato të shqiptarëve të Kosovës. Nëse kënga dhe poezia gojore janë tejet të zhvilluara historikisht në Shqipëri, kjo ndodh thjesht për faktin se gjuha e shkruar ishte e ndaluar gjatë pushtimit osman prej pesë shekujsh të vendit.

e veçantë, origjinale, në familjen e gjuhëve evropiane.

Katër tiparet themelore të poezisë shqipe: 1. Poezia gojore ka qenë shkollë për lëvizjen patriotike shqiptare, që e ka shoqëruar krejt Rilindjen shqiptare dhe i ka shërbyer në pikën më të lartë zgjimit të ndjenjës kombëtare. Tërë promotorët e Rilindjes shqiptare (rilindësit) kanë qenë para së gjithash poetë, dhe tërë përpjekjet e tyre u kurorëzuan me aktin e shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912. Pikërisht, kjo është forca madhore e poezisë së angazhuar militante, të motivuar dhe të mbështetur masivisht.

2. Poezia gojore i ka shërbyer fuqishëm vetë emancipimit të shoqërisë mesjetare dhe

feudale shqiptare për ta afruar sa më shpejt me botëkuptimin përparimtar të kohëve moderne, dhe në këtë kuptim, kjo poezi emancipoi edhe vetveten duke u afruar me shkollat poetike evropiane.

3. Poezia gojore çeli perspektiva të reja zhvillimi drejt një poezie që përdor bukurinë e gjuhës për ta bërë këtë edhe më shprehimshëm artistike dhe të pasur në figura letrare. Synohet drejt idealit të poezisë së kultuar artistike dhe në këtë mes vumë në dukje forcën shprehëse të vargut shqip, aftësinë e gjuhës shqipe nga pikëpamja gramatikore, që lejon zhvendosje të lehtë leksiku dhe veshje të tij bukur artistikisht.

4. Më në fund, poezia e kultivuar në këtë

mënyrë ia kthen monedhën e vet poezisë popullore, domethënë, mban gjallë frymën poetike të këtij popullit poet.

Tre etapat (moshat) klasike të poezisë shqipe (sipas prof. Zotos) janë:

Etapa e parë: Rilindja shqiptare, që shkon nga vitet '40 të shek. XIX (me De Radën), deri në vitet '20 të shek. XX;

Etapa e dytë: është ajo e lulëzimit të poezisë realiste e kritike kur shohim të formohet rryma progresiste e viteve '20-30' dhe që kulmon me Migjenin. Ky autor i fuqishëm shqiptar, ndër poetët e parë modernë njihet për forcën e fjalës, me varg të lirë e të ngjeshur, por edhe të shkurtër: "Unë jam djepi juaj, dhe ndoshta varri juaj", shkruan ai për vargun e tij poetik. Për herë të parë shohim tek ai lindjen e prozës poetike shqipe.

Etapa e tretë: është ajo e izolimit dhe e hermetizimit të vendit gjatë sistemit komunist, konkretizuar me rrymën e soc-realizmit, që zgjati rreth pesëdhjetë vjet dhe që kulmoi në vitet 60-70, kur poezia veshi petkun zyrtar të ideologjisë sunduese, po ku dalluan edhe poetë disidentë, që i largoheshin rrymës ideologjike e për më tepër që u persekutuan e u dënuan rëndë për mos pajtim me sistemin në fuqi. Mbi 200 intelektualë të shquar, shkrimtarë, artistë, poetë, përkthyes, etj. njihën shtypje, tirani, martirizim dhe ndër të tjerë përmendëm fatin tragjik të poetëve martirë të demokracisë Trifon Xhagjika, Vilson Blloshmi, Genc Leka dhe Havzi Nela, duke u ndalur konkretisht në vargun e tyre të lirë e fuqishëm dhe në vdekjen torturoese, me pushkatim apo varje.

Një etapë e katërt vazhdon sot me poezinë e quajtur moderne të autorëve të rinj poetë.

Në zbërthimin e këtyre etapave u ndalëm në mënyrë të veçantë në poezinë e Rilindjes shqiptare, para, gjatë dhe pas saj, duke vënë në dukje se poezia e Budit dhe e Bogdanit në shekujt XVI-XVII, edhe pse me theks kënge tradicionale të krishterë, ishte para së gjithash përgjigje e drejtpërdrejtë e regjimit osman.

Në etapën përgatitore të Rilindjes dhe të poezisë së saj të angazhuar u dalluan fillimisht poetët e diasporës shqiptare, pasuar drejtpërdrejt nga poetët brenda vendit: De Rada, si shtylla e fillimit të Rilindjes njihet nga afër poezinë klasike dhe romantike evropiane të shek. XIX dhe mbante lidhje epistolare me Lamartinin, Hygonin, Mistralin dhe Dora d'Istrias. Këtu u ndalëm posaçërisht te figura e Dora d'Istrias, duke qenë se ky vit përkon me 190 vjetorin e lindjes së saj dhe 130 vjetorin e vdekjes. Duke vënë në dukje origjinën e saj shqiptaro-rumune dhe duke theksuar lidhjet e ngushta që ajo mbante me rilindësit tanë, ngritëm lart figurën e saj si princeshë e kulturës evropiane, që ka kapur e zbërthyer thelbin e shpirtit poetik të mbarë popujve të Europës me 30 esetë e saj të mrekullueshme, botuar në Revistën prestigjioze franceze "Revue des Deux Mondes", nëpërmjet të cilave nxjerr në pah e zbërthen me penë të fuqishme lidhjen e ngushtë kombësi - poezi popullore. Me këtë rast, në prani të Znj. Ana Maria Gurlenau, pedagoge dhe drejtore e departamentit të studimeve rumune UNISTRA (e cila na miratoi në propozimin tonë), formuluan kërkesën që Pllaka përkujtimore që mban emrin e Dora d'Istrias (Helena Ghica) në një nga sheshet e Strasburgut të pasqyrojë

origjinën e vërtetë të saj si shqiptaro-rumune dhe jo vetëm rumune. Th克斯uam se ky propozim i ynë i bën nder jo vetëm Rumanisë, por edhe Shqipërisë në kuadrin e Ewropës së Bashkuar, duke qenë se shumë herë vetë Dora d'Istria ka pohuar origjinën shqiptare të saj dhe të krejt familjes princërore Gjika. Shpresojmë që kjo kërkesë e jona të merret parasysh nga autoritetet e Bashkisë së Strasburgut, dhe të ndiqet nga përfaqësia shqiptare pranë Këshillit të Ewropës.


Poezia shqipe shfaqet që në fillim të shekullit XIX në përmbledhjet e këngëve historike dhe heroike të Greqisë, përkthyer frëngjisht nga M. Mépomuçène dhe L. Mercier, si dhe në antologjinë e përgatitur nga Claude Fauriel, ku zinin vend heronjtë dhe udhëheqësit arvanitas të Revolucionit grek dhe të pavarësisë së Greqisë (1821-1824), për të cilët do të kushtonte vargjet më të bukura të "Orientaleve" të tij vetë Viktor Hygoi, duke ngritur lart bëmat e shqiptarëve. Po ashtu, vend të nderuar zinin këtu edhe Udhëpërshkrimet e konsullit frëng Pouqueville nëpër Shqipëri e në pashallëkun e Janinës kur flet veçanërisht për këngët polifonike, si dhe punimet e filologut frëng Auguste Dauzon për poezinë popullore shqipe, të gjuhëtarit Louis Benloew për metrikën e poezisë popullore shqipe, etj. Por, interesimi i publikut në Villa Schützenberger u bë edhe më i madh kur vumë në dukje se në dy raste konkrete historike, poezia shqipe, e sublimuar në këngë do të shërbente si "melhem" shërimi për dy gjeni të mëdhenj të letërsisë botërore: për Shateaubriand-in, pararendësin e romantizmit francez dhe emër i madh i Letrave frënge, dhe për Lord Bajronin, poetin e ndritur të Letrave angleze, i cili mbante përherë një shpurë shqiptarësh besnikë gjatë udhëtimeve të tij nëpër Greqi e Shqipëri. Në fakt, do të ndodhte që Shatobriandi i madh do të sëmurej rëndë, me temperaturë të lartë në Kerathia (Athinë) dhe do të strehohej për një javë rresht në kasollen e një arvanitasi, ku një vashë shqiptare do përkujdesej për atë duke i njomur ballin me napë me uthull, pa e ndërprerë këngën e saj shqipe gjatë tërë ditës ("në gjuhë të panjohur", thotë poeti i "Kujtimeve përtej varrit"), dhe pikërisht ajo këngë shqipe do të shndërrohej në shtrat shërimi të vetë poetit dhe politikanit të madh frëng Shatobriand. Ja pra, forca e poezisë së kënduar shqipe, e asaj kënge-poeti, që mban gjallë mbi të gjitha shpirtin e paepur të popujve!

Po ashtu, Bajroni, që do të përjetësonte shqiptarët, veshjet, armët dhe këngët e tyre, u sëmur rëndë gjatë udhëtimeve nëpër Epir, dhe trimat e tij shqiptarë të pandarë e mbajtën mbi supë në shtrat prej druri dhe pikërisht, në përumbje të plotë nga ethet, do të ndiqte mes erërave, shiut, furtunës, tallazeve, jehonës e këngës polifonike shqipe (labe), që vinte nga thellësitë e kohërave, atë këngë që ishte bërë për të burim frymëzimi për vargjet hyjnore të "Çajld Haroldit". Ai është ndër të parët autorë të huaj që sjell të transkriptura edhe dy këngë të lashta shqipe në epistolarin e tij.

Tipar themelor i poezisë së Rilindjes shqipe është se tërë promotorët e saj janë poetë, ashtu sikurse tërë arsimtarët e shkollave të para shqipe të çelura në fund të shekullit XIX janë poetë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ideologët e lëvizjes politike të Rilindjes dhe për drejtuesit e kryengritjeve të armatosura që ishin në një pjesë të mirë edhe këta poetë. Pikërisht një fakt i tillë i përgjithëson shqiptarët si popull poet e luftëtar dhe se pavarësia shqiptare është fryt i shpirtit rilindës e liridashës të këtij populli. Numërohen mbi njëqind poetë rilindës shqiptarë të njohur për poezitë e tyre militante të fuqishme, e ndër ta vend të nderuar zë Naim Frashëri, i konsideruar edhe si poeti kombëtar shqiptar.

Temat kryesore të poezisë rilindëse shqiptare janë: dashuria për atdheun, dashuria për gjuhën amtare, glorifikimi i historisë e i herojve të Shqipërisë, konkretisht Skënderbeut, Heroit kombëtar shqiptar, për nder të të cilit ky vit u shpall "Viti Skënderbeu - 2018", që po festohet me madhësi në mbarë kombin shqiptar me rastin e 550 vjetorit të vdekjes së tij.

Domosdo, detyra kryesore e Rilindjes shqiptare ishte pavarësia e vendit, çlirimi nga





zgjedha e perandorisë osmane, por kjo detyrë e shenjtë shkonte më larg: drejt emancipimit të mbarë shoqërisë, drejt progresit të saj dhe integritimit në familjen e madhe evropiane. Në këtë drejtim, poezia e kultivuar dhe e angazhuar shqipe kishte një theks mjaft kritik dhe nuk është aspak rastësi nëse mojtja e Rilindjes Shqiptare ishte: "Mos shikoni kishë e xhamia, feja e shqiptarit asht shqiptaria". Janë në fakt, vargjet më të fuqishme të poetit Pashko Vasa në poezinë e tij "O moj Shqypni". Ngaqë kërcënimin i konflikteve fetare rëndonte ashpër në Shqipëri. Po ashtu, vend i rëndësishëm i njihej që në atë kohë shkollimit të gruaz shqiptare dhe rolit të shkollave për të luftuar analfabetizmin masiv.

Vlen të theksohet roli që luajti Diaspora shqiptare gjatë periudhës së Rilindjes kombëtare - e cila ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me poezinë evropiane - duke përgatitur botime të shumta tekstesh shkollore dhe përmbledhesh poetike, sidomos në Rumani, Itali, Bullgari, Francë, Belgjikë, Egjipt, etj. Në këtë mes, Faik Konicë, një personalitet i shquar shqiptar me përmasë evropiane, sa shkrimtar, botues, gjuhëtar, përkthyes aq edhe poet me varg elegant, dhe që vepronte në Francë, Belgjikë e Angli, mbante lidhje të ngushta me poetin e shquar Guillaume Apollinaire dhe ndiqte nga afër zhvillimet e poezisë simboliste dhe të krejt plejadës së

Roli i diasporës shqiptare

Vlen të theksohet roli që luajti diaspora shqiptare gjatë periudhës së Rilindjes kombëtare, e cila ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me poezinë evropiane - duke përgatitur botime të shumta tekstesh shkollore dhe përmbledhesh poetike, sidomos në Rumani, Itali, Bullgari, Francë, Belgjikë, Egjipt, etj. Në këtë mes, Faik Konicë, një personalitet i shquar shqiptar me përmasë evropiane, sa shkrimtar, botues, gjuhëtar, përkthyes aq edhe poet me varg elegant, dhe që vepronte në Francë, Belgjikë e Angli, mbante lidhje të ngushta me poetin e shquar Guillaume Apollinaire dhe ndiqte nga afër zhvillimet e poezisë simboliste dhe të krejt plejadës së poetëve simbolistë. Revista e tij "Albania" pasqyron ndër të tjerë, edhe mjaft poetë evropianë e botërorë, klasikë e modernë.



poetëve simbolistë. Revista e tij "Albania" pasqyron ndër të tjerë, edhe mjaft poetë evropianë e botërorë, klasikë e modernë. Lidhur me moshën e tretë klasike të poezisë shqipe, në Takimin botëror të Poezisë u ndalëm në mënyrë të veçantë të poezia "Kur

të vdes" e poetit martir Havzi Nela, të cilën e recituum dy herë gjatë takimeve tona me lexuesin frëng të poezisë, pasi theksuam fatin e tij tragjik dënuar me varje nga diktatura komuniste, dhe akoma më tragjik "varrimi" i tij në një vrimë të mbetur bosh nga heqja e një shtylle elektrike në një vend të humbur, që u gjet me vështirësi pas pesë vjet kërkimesh. Edhe vetë nuk i mbajtëm dot lotët gjatë recitimit, dhe duartrokkitjet që pasuan, dhe lotët tek disa të moshuar, ishin si një tufë lule, me simbolikë tashmë botërore, mbi varrin e Havzi Nelës, ashtu siç ishte edhe dëshira e tij e fundit në poezinë e tij: "Kur të vijë pranvera/Kur bilbilni nis me këndue/Mbi varrin tim me gurë e ferra/Nji tufë lule me ma lëshue". Po ashtu, përshypje të thellë tek të pranishmit bëri vdekja tragjike me pushkatim e poetit Trifon Xhagjika që më 1963, si dhe komenti ynë për poezinë e tij "Atdheu është lakuriq", ku poeti denoncon fuqishëm kastën në fuqi për të keqen që i ka futur në trup, kokë, shpirt krejt atdheut, në prag të vetizolimit, hermetizimit dhe diktaturës komuniste.

Vend të veçantë i kushtuam poezisë së Moikom Zeqos, ku bëmë këtë prezantim për autorin dhe recituum në frëngjisht poezinë e tij nga më të fundit "Psalmi 160":

"Moikomi, i vetmi në botë që mban një emër të tillë kaq original, ka një korpus voluminoz poezie, të cilën e praktikom me zell, eth e përkushtim që nga adoleshencia e tij. Është sot Boris Viani shqiptar, duke qenë ai vetë njëkohësisht historian, arkeolog, poet, piktor, shkrimtar, gazetar, filolog, publicist, erudit. Mjeshtëri i lirisë së fjalës, e kërkon forcën shprehëse të verbës poetike në një përmasë (dimensionalitet) të shumëfishitë, duke shkuar gjer në kufijtë e përtej-përmasësisë (supra-dimensionalitetit). Të shkruash ndryshe, është tipari themelor i poezisë së tij që i hedh rrënjët në poezinë futuriste, surrealistë, simbolistë, si dhe në një univers tepër original, ku bota njerëzore, artistike, letrare, madje filozofike pasqyrohet nëpërmjet forcës magjike të verbës së tij poetike. E ndjen veten sa në parajsë të bukurisë artistike, ku vallëzojnë nimfa të botës shpirtërore me krahë fluturash e pilivesash, aq edhe në ferrin e lumenjve infernalë, ku fjalët grinden, duke mbjellë erëra e stuhi. Poet me tejdukshmëri të larmishme, i etur për metafora e alegori, Moikomi dallohet nga universalizmi i tij poetik brenda një marrëdhënieje të ngushtë kohë-hapësirë, njeri-natyrë, dhe realitet metafizik-realist sensual. Është arkitekti i fjalës poetike shqipe par excellence.

Edhe më thjesht, vargu është tek ai një emocion i përhershëm, duke testuar pareshur të shkuarën, të tashmen e të ardhmen, është burimi i tij i pashtershëm jetësor e krijës. Moikomi di të pikturojë me fjalë, duke zotëruar mjeshhtërisht ritmin dhe muzikalitetin e vargut shqip, duke shquar me trop dhe duke u bashkëngjitur ide e figura letrare nga më të çuditshmet e më të ndryshmet.

Është i përkthyer në shumë gjuhë."

E

EKSPOZITA

Në ekspozimin e Kristo Krisikos kemi një narracion specifik të autorit me punë në artin pamor që u realizuan në prag dhe fill pas rënies së komunizmit. Nëse kolegë të tjerë të ngërthyer nga kanonet e komunizmit mbetën në format madhështore, ku kishim figura të ngrira, sa madhështore dhe po aq paradoksale, një art të blatur nga megalomanitë e një sistemi paranojak dhe diktatorial, sipas kuratorit Isufi, kjo nuk ndodhi me Kristo Kristikon qoftë edhe në 'Njeriun e tij të Ri Socialist'...

Punët e Krisikos tregojnë se skulptura shqiptare ka fizionominë e vet

NGA BEN ANDONI

Prej ditësh vepra të dimen sioneve të ndryshme skulpturore rrethojnë Akademinë e Arteve në Tiranë. E gjithë krijimtaria e një skulptori të njohur vjen më e koncentruar në sallën e ekspozitave të Galerisë FAB, kuruar nga dy pedagogë të Akademisë, Ardian Isufi dhe Sadik Spahia. Në forma që të sjellin shumë në përfytyrim veprën e Henry Moore, punët e Kristo Krisikos përcjellin emocione të ndjera por edhe parametra shumë të lartë artistikë. Punimet, e realizuara para dhe pas viteve '90, tregojnë nivelin e lartë të kësaj gjinie, por edhe emrin e një autori që prej 25 vitesh nuk është më aq familjar për shqiptarët...prej largësisë.

Në fakt, të mjaftonte të shikoje pjesëmarrjen e publikut në të dhe vlerësimin e personazheve të ndryshëm të artit për të kuptuar se kjo ekspozitë i takonte kryeqytetit kohë më parë për të sjellë një artist që ka dhënë aq shumë për artin shqiptar.

Koleksioni i pasur, i cili prezantohet në këtë ekspozitë, përshfaq talentin e autorit por edhe frymën e jashtëzakonshme të lirisë, që ai e abstragon me format e larmishme, duke nisur me projektin skulpturore realizuar në qeramikë të Bankës së Shqipërisë prej fundviteve '80 dhe punët e ndryshme realizuar në kohët tona.

Është e vërtetë se një njeri, i cili nuk e pëlqen skulpturën stepet pak nga punët e Krisikos. Kjo sepse format e shumta në dukje të çrregullta që e grishin kureshtjen të duhet pak drejtim për të kuptuar se ku synon dhe çfarë realizon arti i tij. Në esencë është qendërsia femërore e thelbit kulturologjik të shikimit të botës. Por, forma e materies gjenitale, që ai ndërton, shpesh abstragohet dhe përcjell emocionin shqisor të qenies artistike. Në këtë kërkeshje koncepti, që jepet me forma të zhërvjellta një sy i kujdesshëm kupton perceptimin e lartë të autorit por edhe talentin për ta zbritur te publiku emocionin e tij artistik. Kjo lloj sinteze përfshin në vetvete ato që qenia mund të kap më shumë përmes logjikës sesa vështrimeve apo njohurive të ndryshme estetike.

Ekspozita e Krisikos, e titulluar "PROLOG", na sjell në një farë mënyre dhe evoluimin e artistit përgjatë një eksperience të gjatë artistike në gjinë të ndryshme por edhe perceptimeve artistike përballë realiteteve artistike të Shqipërisë dhe Greqisë. Autori e përshkruan në mënyrë të qartë por edhe me një domethënie të madhe në kohë dhe hapësirë të gjithë idenë e vet përmes punëve të formave të ndryshme.



Për specialistët, vepra e tij, është një domethënie metamorfozash formash të abstraguara, apo thënë ndryshe "forma në zhvillim", që na përshfaqin një afirmim dhe konceptim të ri artistik të autorit në perceptimin e tij artistik të viteve të fundit. Skulptura, sipas kuratorëve Isufi dhe Spahia, na tregon një dimension tjetër në kërkim duke evidentuar më shumë procesin e formave në lëvizje sesa aspektin figurativ. Ato të japin ndjeshmërinë e një arratisje volumesh pa adresë por që gjithmonë duhet thënë se na kthehen në destinacione kompozicionale të konceptuara qartë, do të referonin më poshtë kuratorët e tij.

Artisti në zemër të krijimtarisë ka siç përmendëm edhe më lart femorin në formë realiste dhe abstrakte. Dhe qysh në disa vizatime të hershme, që janë të ekspozuara sot në një cep të FAB ai na sjell shenjat e këtij abstraksionizmi të veçantë në skulpturë. Në këtë ekspozitë ai sjell një këndvështrim tjetër të femrës me prezantimin e këtyre punimeve.

Për artistin
Artisti Kristo Krisiko erdhi fizikisht me punën e tij gati 2 dekada e gjysmë më vonë në Shqipëri. Për komunitetin artistik të vendit ishte i njohur, kurse për një pjesë të vogël syresh, ishte edhe më i njohur për arritjet në shtetin fqinj ku ka ngritur jetën e tij të re.

Për fat të keq dhe për ironi të së tërës, ai u nda si shumë bashkatdhetarë për një jetë më të mirë dhe shenja e kësaj ikiye na pret në ball-



inën e FAB me projektin skulpturore në qeramikë të Bankës së Shqipërisë, që daton në fund të viteve '80-të, e cila edhe pse fitoi nuk mund të jetë atje, për shkak të paradokseve tona që nuk reshtin kurrë. Gjithsesi, një shikues e kundron në një formë shumë të këndshme, falë dhe shpjegimit në konceptin kuratorial të Ardian Isufit dhe Sadik Spahisë.

Krisiko mbetet i interesuar në transferimin e duhur të perceptimit që mund të ndodhë midis objekteve dhe shikuesve të saj. Pasi dihet që veprat tridimensionale i lejojnë njerëzit të kuptojnë mënyrat se si trupat e tyre fizikë janë të implikuar brenda narracioneve të ndryshme. Në një farë mënyre puna e tij i ndihmon njerëzit të kuptojnë sa thellë shkon perceptimi dhe abstragimi i qenies humane,

sidomos drejt botës femërore dhe domosdoshmëria e njohjes së duhur në mënyrë që të fillojë realisht afirmimi në konceptimin e tij.

Objektet e artistit, në një farë mënyre, janë diçka si *mbetjet* e njeriut, duke reflektuar personalitetet dhe gabimet - "dëshira jonë, grykësia, obsesioni me pushtetin", siç thonë kritikët e sotëm. Për kuratorin Ardian Isufi, veprat, fillimisht duken si një arratisje volumesh pa adresë, por që gjithmonë kthehen në destinacione kompozicionale të mirë shënuara. "*Materia e formës kozmoseore ndërthuret me forma kozmogonike, sikur shkelin 'njerëz të rinj në tokë të lashtë' nëpërmjet një futurizmi më shumë mental sesa estetik*", shton Isufi, duke ofruar qasjet e duhura instinktive të psikologjisë sonë.

Krisiko Krisiko, e ka nisur kar-

Punët e Krisikos

Është e vërtetë se një njeri, i cili nuk e pëlqen skulpturën stepet pak nga punët e Krisikos. Kjo sepse format e shumta në dukje të çrregullta që e grishin kureshtjen të duhet pak drejtim për të kuptuar se ku synon dhe çfarë realizon arti i tij. Në esencë është qendërsia femërore e thelbit kulturologjik të shikimit të botës. Por, forma e materies gjenitale, që ai ndërton, shpesh abstragohet dhe përcjell emocionin shqisor të qenies artistike. Në këtë kërkeshje koncepti, që jepet me forma të zhërvjellta një sy i kujdesshëm kupton perceptimin e lartë të autorit por edhe talentin për ta zbritur te publiku emocionin e tij artistik. Kjo lloj sinteze përfshin në vetvete ato që qenia mund të kap më shumë përmes logjikës sesa vështrimeve apo njohurive të ndryshme estetike.

rieren si piktor në fabrikën e porcelanit në Tiranë në vitet 1958-1968. Pesë vjet më vonë do të diplomohet me sukses në Institutin e Lartë të Arteve të Tiranës, në një drejtim që do të shënonte të ardhmen e vet. Materiali i tij më i dashur ka qenë qeramika, duke zgjeruar punën e tij edhe me skulpturën. Puna e tij është e njohur për format e larmishme, që na u shfaqën dhe në këtë ekspozitë, por edhe në konceptet që ka ditur t'i përcjellë si duhet te figurat por edhe për ndërlikimin e modeleve gjeometrike.

Në të gjithë këtë ekspozim, kemi një narracion të ri në artin pamor fill pas rënies së komunizmit, që duket si një paqim i artit mes dy kohëve dhe realiteteve. Nëse kolegë të tjerë të ngërthyer nga kanonet e komunizmit mbetën në format madhështore, ku kishim figura të ngrira, sa madhështore dhe po aq paradoksale, një art të blatur nga megalomanitë e një sistemi paranojak dhe diktatorial, sipas Isufit kjo nuk ndodhi me Kristo Kristikon qoftë edhe në pasqyrimin e 'Njeriut të tij të Ri Socialist'. Krisiko mundohet ta humanizojë sa më shumë punën e tij dhe këtë jo vetëm ana njerëzore por edhe deri të lëvizja e njeriut të thjeshtë, me brishtësinë e vet dhe intimitetin e madh të njeriut me artin, do saktësonin kuratorët, që i dhanë frymën e duhur perceptuese autorit.

P

POEZIA

Një përsiatje për kohën ku jetojmë dhe udhëkryqet që has individi shqiptar në këto realitete. Sugjerojmë se autori mund të shkonte më mirë afër prozës në këtë valë mendimesh...



NGA ALFRED MEHMETI

PARA FILLIMIT TË FILLIMIT

Shumë gjëra ndodhën
para fillimit të fillimit.

Shumë gjëra që u harruan
dhe ky ishte fundi,
fundi që shtrihej para fillimit të fillimit.

Pak a shumë si të duash
që të zbulosh e të çelësh një portë,
por t'i qasesh asaj nga ana e gabuar
dhe ndërkohë që ti mendon se e ke hapur,
atë e ke mbyllur përgjithmonë.

Kështu që jo më kot,
para se ne të hynim...
diñim,
më parë se të fillonte nisja...
fillonte kthimi.

PEIZAZH DIMËROR
NGA ATDHEU

Ndalova mu atje në mes të rrugës
për të ndezur një cigare
mes fushëtirës pa rrugë mbuluar krejt nga bora.
(fushëborë e pamatë e atdheut tim diellvogël)

Një muzikë ere frynte nga të gjitha anët,
e përvajshme me tinguj brisku e që të priste si
brisk;
pemët e zhveshura tundnin degët, si ca shko-
pinj dirigjenti
e një kope dhish si një kortezh shkonte mes
pemëve
udhëhequr nga tingujt si prej kambane të ziles
së një çjapi...
në mungesë të bariut.

Muzikë ere, tinguj kambane, një tufë dhish,
si një kortezh i përzishëm nisur drejt varrezës
për të varrosur kë... a thua vetë bariun,
për të varrosur ku, në ç'varrezë...
mes bardhësisë së varrezë të këtij peizazi,
plot brigje e dallgë e duna dëborë
ku si ca hije të mugëta përtej presin ujçërit.

Ndalova mu atje në mes të rrugës
për të ndezur një cigare
mes fushave pa rrugë mbuluar nga bora krejt
dhe m'u duk se aty kisha një përjetësi, një jetë:
genie e ngrirë harruar mes dëborës
aty kisha lindur ... aty kisha vdekur.

MAKTH

Ai zgjohet në mëngjes
dhe ëndrën e shikuar në gjumë gjatë natës
fillon ta pronësojë në telajo.
(ai ka lekë...pashtershmërisht ka lekë)

Si fillim nga gjeografia e botës,
ja ku merr vetëm disa male,
që i vendos në sfond të telajos...
(eh, bota ka male me shumicë
dhe s'dëmtohet nga kaq pak gjë)

Më pas merr disa përrën timer, lumenj,
që i vendos të rrëshqasin tatëpjetë maleve:
silueta të kaltra që bëjnë ski...
(dhe bota fillon të vuajë nga etja,
disa dete dhe liqene fillojnë të shteren,

fillojnë të mpaken si qenie shëndetliga)

Më pas merr fushnaja të pafundta me kallëza,
grunaja të arta, të cilat i vendos
në qendër të telajos...
(dhe diku nëpër fusha të shkreta të planetit
drapri i urisë kosit e kosit
kallëza fëmijësh të pangrënë e të brishtë)

Para se të mbushë çekun për të paguar
së fundmi merr diellin në perëndim
dhe e vendos në sfond të telajos...
(ai ka lekë...pashtershmërisht ka lekë...
dhe e gjithë bota zhytet në terr)

Dhe ndërsa i kapitur prej ditë-artit,
në natën që pllakos, ndërsa bie e fle...
atje lart, universi, me mornica yjesh
rënqethet e mban frymën, se ku i dihet
në gjumë atij çasti çfarë ëndre ai sheh...

BU-U-U...SA I TMERRSHËM
NJERIU

Zbresin nga Qielli
e mbi fronat e horizonteve
pasi ulen perënditë,
në amfiteatrin e Tokës shohin
sesi luhën tragjeditë,
sesi linden mijëra vdekje të reja
çdo ditë... çdo ditë.

"Bu-u-u...sa i tmerrshëm njeriu!"

E ndërsa sërish netëve
perënditë ngjiten lart në Qiell,
plot rënqethje e tmerr,
duke ndezur qirinjtë e yjeve,
nuk dihet se cilës perëndie
perënditë i luten për fatin e tyre.

"Bu-u-u...sa i tmerrshëm njeriu!"

GJOBA NGA E ARDHMJIA

Sot ma gjeti adresën
një tjetër dëng me gjoba
të faturuara nga e ardhmja.

Sikur të mos mjaftonin
kaq e kaq fatura gjobash nga e shkuara:
- Gjobë...për syrin tënd të keq
se me shikimet e tua ke vyshkur
lulet e kopshtit të zonjës Jozefinë...
(e të mendosh që unë sytë s'i kam as të bardhë...!)

- Gjobë...se me këpuçet e tua të përbaltura
ke shkelur hijen e qenushes së zotit Koço...
Sikur të mos mjaftonin këto,
ja pra, ku sot ma gjen adresën
një tjetër dëng me gjoba,
të faturuara tashmë nga e ardhmja.

E para vjen nga viti 2031,
edhe pse tani jemi në vitin 2014:
- Gjobë se me makinën tënde rrangallë

ke shtypur macen e deputetit filan...

- Por unë s'kam as patentë! - protestoj.
Dhe as që kam ndërmend, as ëndërroj
që në të ardhmen të blej makinë ndonjëherë.
- E di ti - më thonë - apo e dimë ne?!

E dyta...nga viti 2055:
- Gjobë...për nxitje dhe pjesëmarrje
në një protestë të paligjshme kundër gjobave!

E treta...nga viti 2069:
- Gjobë...për parashikimin ogurzi
dhe fatkeqësisht jo të rremë
ndaj kryeministrit të vendit,
i cili do bjerë nga kolltuku
e do të thejë kërbishten.

Tjetra...nga viti 2098:
- Gjobë për...
- Nga viti 2098?! - shqajë sytë.
Por unë atëherë i takon
që të jem njëqind e njëzetë e pesë vjeç
ose më saktë...të mos jem fare në jetë!
- E di ti apo e dimë ne?! - më thonë.
Pale, po e mban veten dhe për profet!

Plasin mbi tavolinë dëngun e gjobave
dhe largohen.

U ENDËN SHPIRTRAT E
SHIRAVE TË VDEKURA

U endën shpirtrat e shirave të vdekura,
në kërkim të një strehëze,
qiell pas qielli...si beduinë,
gjersa gjetën për t'u strehuar
gjoksin e popullit tim.

Dhe që atëherë, nga sytë e tij
shi rígon përherë,
prej shekujsh, prej motesh,
si në një përmbytje botësh,
o popull lotësh,
që nga sytë rígon përherë
shira lotësh...lot shirash
mbi një tokë të shkretë e djerrë.

Ç'ËSHTË KY POPULL?!

Ç'është ky popull që kapërcen shekujt...
ecën e ecën e në vend mbetet?!

Njëra këmbë para...pas shkon këmba tjetër,
ç'është ky popull që ecën e ecën?!

Përreth borë e akull...në krahë mban veten,
ç'është ky popull që ecën e ecën?!

Njëra dorë që lyp...i zgjatet dorës tjetër,
ç'është ky popull që ecën e ecën

qarkuar përreth nga horizontet e vdekjes?!

NDERI KA FILLUAR TË
MBILLET TASHMË

Nderi ka filluar të mbillet tashmë
në tokën e turpit...prej gjithsecilit:
prej të gjallëve e të vdekurve, prej baballarëve e
bijeve,
prej stërgjyshërve e të palindurve akoma.

Farat prej kohësh janë varrosur poshtëdheut,
filizat prej kohësh kanë dalë në dritë,
trungjet prej kohësh janë burrruar në drurë.
Gjithsecili i mburret gjithsecilit me pemën e vet,
me kurorën, me hijen, me rekordin e saj qiellor,
paçka se secila pemë nderi është një fotokopje,
motër siameze e çdonjëre peme tjetër.

E njëjta pemë nderi, që gjithsecili e shpall të
shenjtë,

kurbane duke i bërë...duke e ujitur me gjak,
të njëjtat gjethë hithrash...degëve të saj,
që të përvëlojnë e të bëjnë të skuqesh,
të njëjtët fruta qeporë në ajër,
që të bëjnë të lotosh, kur i zhvoshk.
Pemë nderi: degë e trungje, shkopinj e kryqe,
për të rrahur publikisht këdo që rron me nder,
por nuk ka se ku ta mbjellë një pemë nderi...
për të kryqëzuar këdo që nuk e ka një atdhe,
se ka turp të ketë atdhe...një tokë turpi.

JETOJ NË NJË VEND

Jetoj në një vend,
që ekziston ende në hartat e hapësirës,
por është zhdukur nga hartat e kohës,
zhdukur është nga hartat e kujtesës.

Jetoj në një vend,
që mban mend gjithçka:
emrat e objekteve, të sendeve,
të maleve, të fushave, të lumenjve,
të yjeve e të galaktikave,
por harroi emrin e vet
dhe kur e pyesin,
ai s'di të thotë sesi quhet,
kështu që edhe atë vetë
tashmë e kanë harruar.

Jetoj në një vend,
të përrjashtuar nga ligjësitë e universit,
ku asgjëja dhe hiçi
kanë peshën më të rëndë të gravitetit,
asgjëja dhe hiçi
kanë perimetrin dhe sipërfaqen më të madhe,
asgjëja dhe hiçi
mund të shiten e të blihen shtrenjtë
dhe diçkaja...gjithçkaja
kanë peshën dhe sipërfaqen zero
dhe nuk kushtojnë as edhe një cent.

Jetoj në një vend,
ku për asgjënë
s'mjafton as përjetësia që të flasësh,
kurse gjithçkaja lind e vdes brenda çastit,
ku gëzimet kanë emra trishtimesh,
e trishtimet kanë emra gëzimesh.
Jetoj në një vend,
tek i cili jetojnë miliona zemra,
por ai vetë nuk jeton në zemrën e askujt.

A

APEL

Autori bën një apel interesant për një vend duke e përfunduar me fjalët se... të paktën organet kompetente religjioze nëse e kanë të vështirë të hapin një portë, apo të ndërtojnë shkallë, të paktën të vendosin një pllakat përballë kësaj rruge, ku të shkruhet *Rruga e Fratit*. Do të ishte në nderin e besimtarëve, në nderin e atyre që e mbajnë gjallë këtë toponim dhe në nderin e atij kleriku të shquar që i dha kaq shumë kishës dhe Atdheut.

Rruga e Fratit dhe kleriku Martin Gjonima



NGA YMER HYSA

Rruga e Fratit është një toponim tre qind vjeçar në Gjërmë të Kurbinit. Është një rrugë që ka shumë vlera historike dhe kulturore jo vetëm në vendin ku quhet e tillë, por mbarëkombëtare. E them këtë pasi kjo rrugë e lashtë, që lidhte fshatin Gjonëm me Kalanë e Sebastes për shkak të radhës është quajtur Rruga e Kalasë, por rreth viteve 1700 e në vazhdim, deri në ditët tona, kur në krye të kishës Françeskane Shqiptare ishte Frati i Madh Martin Gjonima si i pari i Provincës Françeskane Shqiptare, kjo rrugë mori emrin e tij duke mbetur për tre shekuj si Rruga e Fratit.

Përse dua ta trajtoj dhe ta bëj publike si shqetësim këtë rrugë. Arsyeja janë sa historike po kaq bashkëkohore. Nëse do kthehemi pas në histori, padiskutim që duhet të shpjegojmë se cili ishte Frati i Madh Martin Gjonima. Siç e thashë dhe në krye të shkrimit ai është një trashëgimtar i familjes Gjonima, nga Gjorimi i Kurbinit, një ndër familjet më të hershme fisnike, nga dera e të cilës kanë dalë shumë princër si Progoni, Gjini, Dhimitri si formues të shtetit të Arbrit dhe mjaftë klerikë si Pali, Marku, Gjoni dhe Martini. Me vdekjen e princit legjendar më 1409, vilajeti i tij kaloi fillimisht në zotërimet e Topiasve dhe pak vite më vonë në atë të Kastriotëve. Shumica e banorëve për shkak të qëndrës historike në shekuj ndaj pushtuesve barbarë u larguan nga trojet e tyre duke u zhvendosur në zona më të sigurta si në Parga, Labëri, Shkodër apo thellë në malësinë e Kurbinit etj., duke krijuar fshatra me të njëjtin emër.

Nëse pas viteve 1410 shkëlqimi qëndrestar që ishte shfaqur ndër shekuj nga kjo familje, pas vdekjes së Dhimitër Gjonimës nuk ishte si më parë, fillori të shkëlqente ai fetar. Nga kjo derë më me emër ishin klerikët Dom Mark Gjonima famullitar në fshatin e tij Gjonëm, Dom Pal Gjonima, famullitar në Stana të Dioqezës së Lezhës, si dhe Dom Gjon Gjonima famullitar në Vjerdha të Dioqezës së Sapës.

Në fillim shekullin e shtatëmbëdhjetë, kur identiteti kombëtar, fatet e kishës shqiptare dhe të gjuhës shqipe po rrezikoheshin rëndë nga pushtuesit osmane, kur në krye të kishës katolike ishte Papa Klementi me origjinë shqiptare, pikërisht në

kohën kur u mbajtë në Lezhë Kuvendi Kishtar i Arbërit më 1703 nën drejtimin e Vinçenzo Zmajević, Martin Gjonima (Gjonmi) do ishte një ndër kryesorët e këtij Kuvendi. Prerasti në një letër shkruar më 10 nëntor të vitit 1705 dhe dërguar Kardinalit Saprikante në Romë do të shprehej: "Frat Martin Gjonema ishte i vetmi rregulltar kombëtar që zotëronte një farë talenti dhe ma i mrami Provinciën shqiptare".

Ky frat ndërroi jetë në vitin 1719 duke u prehur i qetë në Kishën Shna Ndoit në Kep të Rodonit, dhe duke mbetur i gjallë në kujtesën e gjorimakëve dhe besimtarët e tij, të cilët rrugës që ai ecte çdo ditë, nga Kisha e Shën Kollit në lagjen Ciprali të Gjorimit, deri të kisha e Shnandoit në Laç i vunë emrin e tij duke e shndërruar në një toponim historik që ruhet ndër breza.

Mund të thotë ndokush kjo rrugë e paska këtë emër, ç'kërkon të thuasht. Pikërisht këtë dua të trajtoj. Ata që më së shumti duhej ta ruanin funksionin e kësaj rruge, pikërisht ata, në mënyrë të pavetëdijshme, për të mos thënë të qëllimshme, po ja humbin emrin. Po ta shohësh me kujdes, ajo dallohet nga larg, që nga rruga nacionale që përshkon fshatin Gjorëm. Dhe pse është rrugë malore me gjatësi mbi një mijë meter, ka një pjerrësi të lehtë rreth pesëmbëdhjetë për qind, duke mos qenë aspak e lodhshme për besimtarët e shumtë që e përshkojnë.

E keqja e madhe është se kjo rrugë ndërpritet pikërisht atje ku duhet të jetë e hapur, pranë kishës së Shna Ndoit, dy herë e bllokuar me gardh me tela dhe një herë pranë kishës me një avlli të lartë, duke e bërë të pamundur përdorimin e saj si rrugë.

Duke mos qenë specialist i mirëfillt për të shpjeguar si mund të bëhet e përdorshme dhe funksionale kjo rrugë, si intelektual dhe studiues, sugjeroj që kjo që them, të merret në konsideratë dhe të krijohet mundësia e përdorimit të saj, ose të paktën organet kompetente religjioze nëse e kanë të vështirë të hapin një portë, apo të ndërtojnë shkallë, të paktën të vendosin një pllakat përballë kësaj rruge, ku të shkruhet Rruga e Fratit. Do të ishte në nderin e besimtarëve, në nderin e atyre që e mbajnë gjallë këtë toponim dhe në nderin e atij kleriku të shquar që i dha kaq shumë kishës dhe Atdheut.

E

ESSE

Në një formë shumë interesante, që të kujton letrën e hapur të Emil Zola J'accuse, një autore që jeton prej viteve jashtë vendit, ka zgjedhur ta përcjellë kështu emocionin e saj. Në respekt të zgjedhjes së saj, po i ruajmë anonimatën...



I nderuar zoti President,
I nderuar zoti Kryetar i Parlamentit
I nderuar zoti Kryeministër
I nderuar zoti Deputet
I nderuar zoti Kryetar Partie
I nderuar Pushtetar

Objekt: Letër Akuzë

Më lejoni të nderuar të lart përmendur t'ju marrë pak kohë nga koha tuaja e çmuar për të zgjidhur problemet e shtetit, problemet e popullit, problemet e përditshme pa të cilat në nuk mund të zgjohemi optimist e nuk mund të flemë paqësor.

Vij nga një familje ku besoj se ngjashmëria me të tjerë nuk është e pakët. Im atë ushtarak i dalë në pension dhe invalid. Shteti për 35 vite pune dhe invaliditetin e tij e shpërblen me një rrogë që ju të lartë-nderuar ua lini bakshish kameriereve kur ju shërbejnë në lokale lukullak për dëshirën që ju ngjallin rrumbullakësitet e tyre.

Nëna infermiere në pension, gjithë jetës u shërbeu me qindra e mijëra pacientëve, juve dhe familjarëve tuaj, ndër-asa tani si shpërblim kur shkon detyrë të spitalit duhet të paguajë çka i mbetet nga fakturat e muajit.

Unë kam mbaruar studimet e larta me medalje ari dhe certifikatat e arrijtjeve të mia, prindërit e mi i kanë vendosur me korniza në dhomën e gjumit ku përpiqen të flemë me ëndrra për të ardhmen time.

Të nderuar të sipërperemendur, bashkangjitur në këtë letër ju do të gjeni dhe foton e një kufome fëmije. Është fëmija që nuk munda të sillja dot në jetë të gjallë sepse zoti i ndëshkon mëkatat. Është fëmija që e lotova nëntë muaj netëve e ditëve duke mallkuar veten përse nuk isha burrë si ju ndoshta ju, por të paktën të mos lejoja askënd të më përdhoste trupin.

Ky fëmijë që nuk e pa dritën e diellit është vulla e turpit tuaj; e kryetarit të Partisë që më priti me buzëqeshje duke më shtrënguar pas vetes si të më kishte motrën e vet, por motra nuk dhunohet zoti Kryetar duke e puthur me zor.

Ai fëmijë është i yti zoti deputet që kërkon takime zyrate natën dhe zotësheshe se sapa të takohemi dy a tre herë unë do ta kem një vend pune pranë jush për të më shfrytëzuar ende derisa një tjetër viktimë do të trokasë në derë.

Ky fëmijë është i juaji kryetar i Parlamentit, zoti Kryeministër, zoti President, zoti Pushtetar. Ky fëmijë-kufome është turpi i një sistemi që çdo ditë

përdhunon të drejtat e një studenteje që përvojë ka vetëm librat, është i një gruaje që për të rritur fëmijët me dinjtet duhet të shkurttojë fundin e të shkopsiti bluzën për t'ju bërë qejfin ju, që gdhini fukarenj e ngryseni miliardierë.

Unë ju akuzoj ju, "baballarë" të këtij kombi, të kësaj fëmije që dërgjet në një arkivol dhuratë detyrë të politikës suaj.

Unë ju akuzoj ju, si një vajzë e përdhunuar që nuk guxoi të shkelë detyrë të drejtësisë se drejtësia jeni ju e unë jam thjesht ajo që refuzoi të bëhej lodra juaj.

Por çdo gjë e ka një çmim, fatkeqësisht jo për ju. Është çmimi i heshtjes së dhjetëra grave që varrosin shpirtin, trupin dhe ëndrrat e tyre për të gjalli. Ironi e fati! Të parët që ngrënë gishtin e ngërdheshen jeni ju dhe zonjat tuaja të nderuara në krahë, të cilat dashurohen me markat, me milionat që burrat u sjellin duke shkelur mbi vuaritjen.

Jo zonja, atyre grave që burrat tuaj u mbyllin derën e zyrës duke u premtuar se do t'u hapin të tjerë dyer po të heshtin për përdhosjen, nuk kanë fuqi as të këlthasin se shëris turpi mbi to do të bjerë.

Jo zonja të nderuara ato nuk janë të përdala, por janë zotërinjtë tuaj që i përdorin dhe i flakin kur të tjerë u trokasin në derë për të kërkuar të drejtën që u takon...

Merrni këtë fëmijë zonja të nderuara dhe varroseni me nderet e duhura se është pjellë e politikës suaj, është zëri që duhet t'u prishë të paktën ëndrrat e një nate: "Erdeha në këtë botë i vdekur për t'ju sjellë mesazhin të gjallëve".

Unë ju akuzoj ju, o njerëz që gjetet një fëmijë të hedhur diku dhe iu sulët me mallkime nënës që e flaku. Ai fëmijë është dhimbja e saj që nuk pati guxim t'ua linte në prehër askujt prej jush të nderuar politikantë.

"Fëmija nuk qesh, por vetëm lëngon, e ama s'e don, por vetëm mallkon. Por mjerimi nuk kërkon mëshirë, por don veç të drejtë. Trupi i vocërrakur, është ba një shtatore e ngurtë e zhgulun nga gjini i nanës. Merrni dhe çonie në qytet këtë shtatore. Vendoseni në një shesh. Dhe si përmendore kushtojani ndokujt. Kushtonia atij që ka më shumë merita për këtë vend. Po ndoj Ministri, o ndoj Deputeti, o ndokuj tjetër... E në rast se nuk gjeni ndoj njeri që ka merita të mjaftueshme, atëherë kushtonia atij që ka merita ma pak: përëndisë klasike..."

Të nderuar të lartë-përmendur, Një grua nuk mund të rrojë për t'u shpëtuar nga një burrë për të bërë të njëjtat gabime.

(Zëri i një nëne të përdhunuar nga zyrat e politikës)

MK

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë, por kurrsesi nuk mund ta krahasoj me dy numrat e fundit. Shkrimi kryesor iu la një argumenti që na solli bashkëpunëtori ynë i "Milosao" nga Irlanda Ndrek Gjini. "Meave de Burgh, personazhi i tij, jeton vitet e saj të pleqërisë në Wexford të Irlandës. Ajo është ndofta e vetmja grua, ende gjallë, që ka punuar si agjente në shërbimin e fshehtë anglez, gjatë kohës që ky shërbim stërviste të rinj nacionalistë shqiptarë në mërgim, me qëllimin për t'i dërguar me mision në Shqipëri për rrëzimin e regjimit komunist". E ëma e artistit të njohur Chris de Burgh mëton se mban mend që në një natë të vetme janë vrrarë plot 300 shqiptarë që desantuan në vend!! Një shumë që është deri më tani e panjohur prej historiografisë shqiptare dhe që redaktori me burimet e tij nuk e konfirmon.

Leka Ndoja, një studiues interesant na solli një punë postmortum së të atit. Në vijim të ciklit të "Kastriotëve", Mark Ndoja shkroi në ishullin e Zvernecit në vitin 1967, tragjedinë në vargje që fillimisht mbante titullin "Vdekja e Skënderbeut" me temë betejën e fundit të heroit deri në fund të jetës. Tragjedia "Beteja e fundit e Skënderbeut", tragjedi me 5 Akte, rimerr personazhet e veprës "Kastriotët", që mbante nëntitullin: "Trilogji kreshnike". Me këtë

dramë për Skënderbeun përmbillet cikli i "Kastriotëve". Këtë tragjedi, autori e rikonceptoi pasi kishte shkruar Aktin I në Tiranë, por duke e vijuar në kushtet e rënda të internimit. Duhet thënë se "Milosao" e botoi në numrin e fundit të vitit, që autoritetet shqiptare ia kushtuan Skënderbeut. Në këtë numër, po ashtu vijuan edhe shkrimin e Aristotel Micit, ku shpjegohet "Memoria" e famshme e Gjon Muzakës, ku trajtohet figura e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Paçka kundërshrive ai e ngre lart atë si një personalitet të shquar, udhëheqës dhe komandant të talentuar, por edhe rrëfen humbjet e mëdha të princave tanë.

Çdo fundviti, sipas një rituali gati matematik, komunikimi me Visar Zhitin dhe bashkëshorten e tij bëhet i gjallë dhe i ndjerë për të kthyer në jetë Atjonin...Redaktori shkroi për filmat turq dhe u tregua shumë kritik me ta. "Balkanin sot nuk e ndjen shumë ekspansionin e politikës turke, prej rrugës që ka hapur kultura e saj, ku shikuesit janë gjithnjë e më të shumtë prej zgjidhjeve racionale alla Balkan dhe problematikave gati identike në rajon. Po në të gjithë këtë hulli, a mund të ketë një kontroll moral të njerëzve që i marrin këto filma, pasi historia jonë po transformohet në një farë mënyre pa u ndalur drejt perceptimeve të tjera, kurse imazhi i Turqisë historike po na vjen i qashtë dhe i këndshëm dhe duket po e zhbën krejtësisht atë errërisë që na la me vetëdijë të plotë...". Mund të themi se ishte numër relativisht i thjeshtë.

Në periudhën Perandorake (27 p.e.re – 395) në fron janë ulur plot 27 ilirë prej të cilëve më të njohurit janë: Diokleciani dhe Konstantini i Madh, e që Aurel Viktori (320-390) për ta do të shkruante: "Atëdheu i të gjithë këtyre ka qenë Iliriku, edhe pse pak të qytetëruar kanë qenë shumë të dobishëm për shtetin" (N.Ceka, Ilirët). Pra, këta perandorë janë puro iliro-shqiptarë, sllavët në Ilirik filluan dyndjen në shek.VI-VII dmth., dy shekuj pas perandorit të fundit ilir..

HISTORI

NGA GAZMEND ÇITAKU*

Shqiptarët padyshim se i takojnë trunqut të popujve më të lashtë si për nga historia ashtu edhe për nga gjuha. Mirëpo shqiptarët janë një ndër popujt të cilët më së paku e kanë të dokumentuar historinë e vet kombëtare.

Periudha e hekurit por edhe ajo antike janë periudha shumë të lavdishme të ilirëve si paraardhësit tanë. A ishin të civilizuar? Me çfarë teknike dhe si i ndërton vendbanimet e veta? Nëse dimë se muret ciklopike janë karakteristike e ndërtimeve ilire atëherë shtrohet pyetja si u skalitën ata gurë gjigand? Kush ishin ata që i skalitën me aqë precizitet dhe në fund me çfarë makinerie apo teknike i ngriten blloqet shumëtonëshe deri në ato lartësi të mëdha?

Dimë për kulturën helene dhe romake dhe padyshim se këto kultura kanë mbërrit edhe në Ilirik. Ato këtu gjetën kulturën ilire e cila ka dhënë kontributin e vet në kulturën e gjithëmbarshme botërore. Helenët, trojet e ilirëve i quanin barbare, derisa Roma nuk mundi t'i pushtojë me lehtësi por iu desh të bëjë luftëra të cilat zgjatën pothuaj 300 vite ku më të njohurat janë Lufta e Parë, Dytë dhe Tretë Iliro-Romake kur përfundimisht bie Mbretëria e Ardiandëve dhe i gjallë bie rob Mbretit Gent. Pasojnë disa kryengritje të cilat zgjasin deri në vitin 6-7 të erës së re e që pas shuarjes së kryengritjeve, Roma me qëllim që më lehtë ta kontrollojë këtë territor formon dy provinca të reja: Dalmacinë dhe Mezinë.

Nuk duhet harruar se fillimisht Roma kishte rregullim: Mbretëror (735-509 p.e. re), Republikan (500 p.e.re – 27 p.e.re) por me ardhjen e Cezarit (50 p.e.re) e përfundimisht nga Augusti (27 p.e. re) fillon era e rregullimit të ri shtetëror pra Perandorisë Romake që udhëhiqet nga perandori i cili sipas një rregulli vinte nga radhët e ushtrisë. Ky rregullim zgjati deri në vitin 350 të erës sonë kur edhe Perandoria ndahet në atë Lindore dhe Perëndimore. Në këtë periudhë falë shkathtësisë së tyre luftarake, guximit dhe ambicies për pushtet u bënë e mundur që për perandorë romakë të bëhen edhe shumë ushtarakë të lindur në Iliri dhe që shumë lehtë vërtetohet identiteti i tyre ilir madje ata edhe inkurajojnë dhe ndihmonin ilirët tjerë që të ngriten dhe avancohen në ushtri. Andaj për një periudhë të gjatë kohore ia arritën që shumë ilirë të mbajnë poste dhe funksione shumë të larta perandorake.

Në periudhën Perandorake (27 p.e.re – 395) në fron janë ulur plot 27 ilirë prej të cilëve më të njohurit janë: Diokleciani dhe Konstantini i Madh, e që Aurel Viktori (320-390) për ta do të shkruante: "Atëdheu i të gjithë këtyre ka qenë Iliriku, edhe pse pak të qytetëruar kanë qenë shumë të dobishëm për shtetin" (N.Ceka, Ilirët). Pra, këta perandorë janë puro iliro/shqiptarë, sllavët në Ilirik filluan dyndjen në shek.VI-VII dmth dy shekuj pas Per-

PERANDORËT ROMAKË ME PREJARDHJE ILIRE



andorit të fundit ilir: Këtu po sjellim listën e Perandorëve Romak që kanë lindur në Ilirik apo kanë prejardhje ilire:

1. **Trajanus Decius** (249 – 251), *Gaius Messius Quintus Taianus Decius*, ka lind në Budallija (Sirmium) sot fshati Martiniqi (Mitrovica e Sremit, Serbi)
2. **Hostilianus** (251), *Gaius Valens Hostilianus Messius Quintus*, djali i Deciusit, ka lind në Sirmium.
3. **Claudius II Gotikus** (268 – 270), *Marcus Aurelius Claudius Gothicus*, është nga rrethi i Sirmiumit ose nga Dardania. Për perandor zgjedhet pasi i mund Gotët në vitin 268 afër Naissusit.
4. **Quintillus** (270), *Marcus Aurelius Claudius Quintillus*, ka lind në Sirmium, është vëllai i Claudit II, vetëm 77 ditë ka qëndruar në fron.
5. **Aurelianus** (270 – 275), *Lucius Domitius Aurelianus*, ka lind në Sirmium sot Mitrovica e Sremit, njihet me atë se Perandorisi Romake ia ribashkon Mbretërinë e Galëve.
6. **Probus** (276 – 282), *Marcus Aurelius Probus*, ka lind në Sirmium, është i pari që lejoi që hardhit Italiane të mbillen në vende tjera të Perandorisë si në Ilirik, Galici, Britani dhe Spanjë.
7. **Diocletian** (284 – 305), *Gaius Aurelius Valerius Diocletianus*, ka lind në Dioclea sot Dukla afër Podgoricës. Një ndër perandorët më të rëndësishëm të Romës. Pas një kaosi të madh shumëvjeçar ai ia arriti që Perandorinë ta vëj në rregull. Duke qenë i vetëdijshëm se Perandoria ishte shumë e madhe dhe që ishte shumë e vështirë të udhëhiqej nga një njeri i vetëm është i pari që vendos të ndajë pushtetin krijon *Diarkin*

(dy AUGUSTË që sundojnë njëri në Lindje e tjetri në Perëndim) dhe kjo ishte fillimi i ndarjes së Perandorisë në atë Lindore dhe Perëndimore.

8. **Maximianus Herculus** (285 – 305), *Marcus Aurelius Valerius Maximianus Herculus*, ka lind në Sirmium. Ilir. mik dhe bashkësundues me Dioklecianin. Së bashku me Dioklecianin jep dorëheqje nga fronti por që pas një viti (306) kthehet prapë në fron dhe e ndihmon në ngritje Konstantinin e Madh. Nga fronti e rrezojnë më 308.
9. **Galerius** (305 – 311), *Gaius Galerius Valerius Maximianus*, ka lindur në Felix Romuliana sot Gamzigrad afër Zajëçarit. Sundoi nga Sirmiumi, ka qenë i pamëshirshëm ndaj të krishterëve madje të gjitha barbarizmat që i vishin Dioklecianit janë rezultat i përndjekjeve të tija. Për grua kishte vajzën e Dioklecianit.
10. **Constantius I Chlorus** (305 – 306), *Flavius Valerius Constantius*, ka lind në Ilirik në vitin 250. Është babai i Konstantinit të Madh.
11. **Flavius Severus II** (306 – 307), *Flavius Valerius Severus II*, ka lindur në Naissus, ka ndarë fronin me Konstantin Klorin.
12. **Licinius** (308 – 324), *Gaius Valerius Licinianus Licinius*, ka lindur në afërsi të Felix Romuliana, mbretëroi në lindje, së bashku me Konstantinin e Madh sollën Ediktin e Milanit. Zhvillon dy luftëra kundër Konstantinit të Madh të cilat i humbet të dyja dhe në fund ekekuotohet.
13. **Maximianus Daia** (311 – 313), *Gaius Galerius Valerius Maximianus*, ka lindur në afërsi të Felix Romuliana, mbahet mend si persekutues i madh dhe se nuk ka pranuar sistemin tetrrak të mbretërimit.
14. **Constantinus I i Madh** (312 – 337), *Flavius*

us Valerius Constantinus, ka lindur në Naissus (Nishi i sotëm). Më 313 nënshkruan Ediktin e Milanit me të cilin lejohet toleranca fetare dhe praktikimi i lirë i fesë së krishterë. Është themelues i Konstantinopolit dhe me ardhjen e tij vie deri te një paqe sociale pas një periudhe të gjatë të persekutimeve fetare.

15. **Constantinus II** (337 – 340), *Flavius Iulius Constantinus*, ka lind në Sirmium dhe është djali i dytë i Konstantinit të Madh. Babai i vet e bën Cezar të pjesës lindore të Perandorisë kurse dy vëllezërit tjerë pjesën tjetër.
16. **Vetranio** (350), i lindur në Mezi, për Cezar e emëroi Konstanti II me kërkesën e vajzës së Konstantinit të Madh. Mirëpo nuk ndenji shumë në fron vetëm dhjetë muaj kur edhe detyrohet të largohet.
17. **Iovianus** (363 – 364), *Flavius Iovianus Augustus*, ka lindur në Singidunum (Beogradi i sotëm) dhe në fron qëndroi vetëm tetë muaj.
18. **Valentinianus I** (364 – 375), *Flavius Valentinianus*, ka lind në Cibala (sot Vinkovci, Kroaci). Fronin e ka ndarë me vëllanë Valensin. Ka mbretëruar përdimim.
19. **Valens** (364 – 378), *Flavius Valens*, ka lind në Cibala (Vinkovci, Kroaci). Fronin e ka ndarë me vëllanë Valentinianin I. Ka mbretëruar lindjen.
20. **Gratianus** (375 – 383), *Flavius Gratianus Augustus*, ka lind në Sirmium. Është djali i Valentinianit I.
21. **Valentinianus II** (383 – 392), *Flavius Valentinianus II*, ka lind në Trir është djali i Valentinianit I i cili ka qenë nga Cibala (Kroaci).
22. **Constantinus III** (421), *Flavius Constantius Augustus*, ka lind në Naissus, është babai i Valentinianit III
23. **Valentinianus III** (425 – 455), *Flavius Placidius Valentinianus*, djali i Constantinus III, njihet si perandori i fundit përdimimor me origjinë ilire.
24. **Marclianus** (450 – 457), *Flavius Marclianus*, ka lind në Iliri, ka mbretëruar në lindje.
25. **Anastasius I** (491 – 518), *Anastasius*, ka lind në Dyrrachium, Durrës, Shqipëri.
26. **Iustin I** (518 – 527), *Flavius Iustinus*, ka lindur në Bederiana të Dardanisës (Leban, Serbi).
27. **Iustinianus I** (527 – 565), *Flavius Petrus Sabbatius Iustinianus*, ka lind në Tauresium të Dardanisës. Justiniani I është imperatori i fundit latin.

*Publicist dhe përkthyes

Opinioni
i Ditës

Vit i mureve ndarës apo urave bashkuese?

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... i triumfit legjendar të "Urës" detare gjigante Euro-Atlantike mbi murin mburojë nazist në Normandi; më 12 maj 70-vjetori i dështimit të bllokadës më të madhe sovjetike në Berlinin Perëndimor falë urës gjigante ajrore të aleatëve dhe më 9 nëntor, 30-vjetori i shembjes së Murit famëkeq të Berlinit. Me të drejtë, ky i fundit u konsiderua si preludi i shembjes së gjithë mureve, gardheve dhe barrierave të komunizmit dhe i ribashkimit gjerman/evropian. Nuk po zgjatemi në këtë ngjarje të trajtuar në shumë botime dhe veprimtari, duke përfshirë dhe librin e autorit "Berlini pa Mure"

Mirëpo, krizat dhe zhvillimet e mëvonshme negative e kanë zbehur jo pak mjaft euforinë dhe entuziazmin e dikurshëm. Kjo, sepse gjatë 30 viteve të fundit janë ngritur mure, gardhe dhe barrierat e gjithfarëllojshme: mure fizike, zgjerimi, elektronikë, azili, raketorë/bërthamorë, etnikë, raciste, fetare, rajonale, tregtarë, ideologjikë, antievropianë, mure krimi dhe korrupsioni, etj. Aq sa duket se po vërtetohet profecia e të madhit Xhevahir Spahiu kur të poezia "Muret" bën pyetjen emblematike "A thua se muret bien e shemben për t'u ngritur përsëri?". Ca më keq akoma, ngrija dhe montimi i mureve po kthehet në sistem për shkak të përshkallëzimit të populizmit, ekstremizmit, euroskeptizmit, proteksionizmit, unilatërisht, etj. Tashmë këto mure po ndajnë shumë vende dhe popuj, organizata ndërkombëtare dhe në përgjithësi rendin e ri botëror që u ngriti mbi 7 dekada më parë, në përpjekje për të shmangur konfliktet të përgjakshme si Lufta e I dhe e II Botërore dhe për një paqe e stabilitet të qëndrueshëm. Kjo po ndodh pikërisht kur sapo u krenuata me madhësi 100-vjetori i përfundimit të Luftës së I dhe 80 vjet pasi plasi Lufta e II Botërore, ku këto dukuri me aktorët/faktorët e lartpërmendur luajtën rolin kryesor. Gjithashtu, këto mure dhe gardhe po pengojnë seriozisht zgjidhjen e krizave dhe konflikteve të stërzgaturat/ të ngjira. Mjaft të përmendim ndarjen e Qipro prej 45 vitesh, të dy Koreve prej 60 vitesh, krizën Izrael-Palestinë, krijimin e konflikteve të reja në Lindjen e Mesme dhe gjetkë. Edhe SHBA-të, kampione të shembjes së mureve po ndërtojnë murin gjigant me Meksikën; madje ndërtimi i tij ka krijuar konfliktin me demokratët, duke çuar në pezullimin e aktivitetit qeveritar për mosmiratimin e fondit të nevojshëm prej 5 miliardë euro.

Lajmi i mirë është se në këtë përvjetor simbolik, Evropa ka një shans të artë për të gjetur vend



me zgjedhjet e reja për Parlamentin Evropian, që plot 40 vjet më parë filluan të bëheshin të drejtpërdrejta. Për shkaqet që u përmendën më lart, sivjet këto zgjedhje janë "përjetë a vdekje" për demokracinë dhe projektin evropian. Prej tyre do të dalin drejtuesit dhe institucioneve kryesore evropiane, pasardhësit e Juncker, Tusk, Mogherini, Tajani, komisionerëve, kryetarëve të grupeve parlamentare, raporterët për vende të ndryshme etj.

Gjendja është e rëndë, sepse dy vitet e fundit, dy grupimet më të mëdha në Parlamentin Evropian, qendra e djathtë dhe e djathtë, si forca anti-mur kanë pësuar firo dhe disfata zgjedhore. Tragjike është gjendja e Partive Socialiste

dhe Social-Demokrate që janë në kufijtë e mbijetesës politike; madje, disave nuk u dëgjohej më emri. Social-demokratët gjermanë janë në kufirin më të ulët historik të 15 për qind duke rrezikuar të kalohen nga ekstremistët e AfD dhe komunistët e reformuar. Kryetari i ri i PES, Stanishev është vësh-tirë të fitojë dhe në vendin e vet në Bullgari. Presidenti i IS, Papan-dereu është sa për formë se nuk ka kush e zëvendësojë dhe në Gre-qi e zënë me "gurë". Po kështu, PS-ja e Timermans, kandidati kryesor për Presidentin i Komisionit Evropian, zv.president aktual në Holandë luhatet në kufirin e 5 për qind e kështu me radhë. Kurse socialistëve francezë, grekë e të tjerëve nuk u gjendet "as nami as

nishani". Në këto kushte, nuk dihet se si mund ta mbajnë vendin e dytë në këto zgjedhje dhe drejtimin e Europarlamentit me qendrën e djathtë. Gjithsesi, me një mobilizim të madh, liderë të besueshëm dhe alternativa bindëse dhe të prekshme zgjedhore, asgjë nuk përjashtohet.

Ndonëse disi më mirë, edhe kristian-demokratët rrezikojnë shumë, sidomos në Francë, Gjermani, Itali dhe gjetkë. Lajm i mirë është rritja e vrullshme e të Gjellbërve në Gjermani, Belgjikë etj., që mund të kompensojnë "firo" e socialistëve dhe të djathtëve. Macron me lëvizjen e tij "En Marche" ishte një shpresë e madhe për krijimin e një blloku ose aleançe panevropiane centrist; por pas protestave më të fundit të "jelekëverdëve", pozitaz e tij dhe të centrizmit janë lëkundur ndjeshëm brenda dhe jashtë vendit. Shtu këtu edhe vepërimitarinë subversive të ish-shefit të fushatës zgjedhore të Trump, Steven Bannon, i cili ka hapur zyrën e lëvizjes së ekstremit të djathtë me qëllim që të "pushtojë" Brukselin dhe ta ndajë atë me një mur të ri të madh nga kryeqytetet e tjera. Edhe populistët dhe ekstremistët anti-ura janë në ngjitje pas fitoreve të bujshme në Itali, Austri, Slloveni, forcimit të pozi-

tave në bllokun e Visegradit etj., në pozita të fuqishme janë ata dhe në Francë, Gjermani dhe gjetkë.

Për pasojë, Evropa pritet të shkojë në këto zgjedhje më e ndarë se kurrë me lloj-lloj muresh dhe alergji ndaj urave bashkuese. Veç shembujve të njohur të mëparshëm, këtë e dëshmoi qartë refuzimi i 15 vendeve, shumica anëtare të BE-së të Paktit Global mbi Migracionin të miratuar në Marakesh dhe në OKB më 19 dhjetor; ndonëse Pakti Global nuk është i detyrueshëm, ndonëse merr parasysh rregullat dhe interesat e vendeve kombëtare dhe plot "ndonëse" të tjera. Po pse atëherë ky "mur dhe gardh refuzimi" dhe nga disa vende ish-lindore etj.? Thjesht për shkak të qëndrimeve refraktare anti-azil të këtyre vendeve në kuadrin më të gjerë të kundërshtimit të multilateralizmit, pra zgjidhjes së këtij problemi madhor në forume shumëpalëshe, duke ia lënë përjashtimisht atë dhe aspektet të tjera vetëm vendeve të prekura. Për më tepër, 30 vjet më parë e deri tani vonë, Hungaria, Polonia dhe Republika Çeke, çelën kufijtë dhe shemben muret për vërshimin e mijëra shtetasve drejt perëndimit, kurse tani po i mbyllin kufijtë me mure gjigandë.

Ndaj, tani, katër muaj përpara zgjedhjeve të reja evropiane, të gjitha forcat politike po mobilizojnë njerëzit për një pjesëmarrje masive, me premtime konkrete, të prekshme dhe të realizueshme, me autokritikë për mungesat dhe dështimet dhe me alternativa më të mira qeverisjeje. Si të gjithë brenda e Ballkanit edhe Shqipëria preket drejtpërsëdrejti nga këto zhvillime. Fatqeqësisht, mijërat e bunkerëve janë zëvendësuar me shumë mure e gardhe të natyrës ekonomiko-sociale për brezin e ri e deri të pensionistët. Protestat e tanishme të studentëve tregojnë qartë se sistemi ka dështuar edhe në drejtim të plotësisht të kërkesave minimale të brezit më të ri, fëmijëve të dhjetorianëve 1990. Për më tepër, në këtë gjendje kaotike të Evropës, për shkak dhe të mungesave tona të pajustifikueshme, ne po lutemi detyrë të BE-së për çeljen e negociatave me BE-në. Moment dhe koniunkturë tejet e disfavorshme. Sepse është tejet e vështirë në ngrësh zërin dhe të kërkosh tani një gjë të tillë përballë aq shumë mureve që po na ngrënë... Gjithsesi, është më e udhës të vijojmë me kryerjen e detyrave të shumta e të prapambetura të shtëpisë, që të pakten të mos "ngelemi në veshetë" dhe ta çajmë e shembim më në fund "murin" që na ndajnë nga integrimi në Evropë. Dhe kujdes ndaj mureve e gardheve të tjerë, sepse ajo çka na duhet tani më shumë se kurrë janë urat lidhëse dhe bashkuese.

Gjendja është e rëndë, sepse dy vitet e fundit, dy grupimet më të mëdha në Parlamentin Evropian, qendra e djathtë dhe e djathtë, si forca anti-mur kanë pësuar firo dhe disfata zgjedhore. Tragjike është gjendja e Partive Socialiste dhe Social-Demokrate që janë në kufijtë e mbijetesës politike; madje, disave nuk u dëgjohej më emri.

Opinion i Ditës

Proteston, prandaj ekziston

Nga Elvis Hoxha

(vijon nga faqja 1)

... bordeve dhe jo protestë për ndryshimin e personave në borde. Bordet janë vendi i legjitimitimit të korrupsionit të vjetër të universitetit, si dhe formimi i një korrupsioni të ri.

Në e dimë shumë mirë që dekani apo rektori janë kthyer në figura të përjetshme. Mjaft të kujtoni emrat e tyre. Kanë mbi 20 vjet që janë shefa, edhe pse nuk përbëjnë as figura intelektuale të shoqërisë shqiptare e as figura të ndritura profesionale. Rektorët dhe dekanët, në më të shumtën e tyre janë aty sepse kanë ofruar shërbime dhe e kanë privatizuar universitetin publik. Ndarja e universitetit në shumë rektorate ishte një mënyrë që do t'i shërbente numrit të njerëzve të bordeve, pra do ta kthente njësinë e bordeve në shpërbim për shumë njerëz të administratës së kryeministrit.

Një universitet i korrupsuar i bën shumë punë një qeverie që synon të korrumpojë e të korrumpohet. Qeverisë "Berisha" i shkonte për shtat një universitet privat pa kriter. Qeveria "Rama" nisi me mbylljen e dy universiteteve private më famëkeqe dhe më pas vijoi me privatizimin e mëtejshëm të universitetit publik. Në një farë mënyre, qeveria "Rama" u tha drejtuesve të universiteteve: "Ju do të bëni pallë në kurriz të universitetit, pra në kurriz të taksapaguesve dhe në dëm të jetës së të riut shqiptar, por nga kjo duhet të fitojnë edhe njerëz të administratës sime".

Politika e qeverisë "Rama", me ligjin e arsimit mund të thuhet shkurt: "Le të ketë oligarkia dhe brenda universitetit. Këta jeni ju zotërinj rektorë e dekanë. Por ne do të dërgojmë pranë jush, si anëtarë bordesh, njerëzit tanë që do t'i ushqeni ju, sepse këta janë njerëzit që na mbajnë gjallë neve në qeveri. Ne po ju falim universitetin dhe ju na ndihmoni të mbajmë qeverinë". Dhe në të gjithë këtë strategji, humbësi kryesor është studenti dhe familja e tij, humbësi i dytë është shoqëria që gjendet me një institucion më pak, pra universitetin, humbësi i tretë është Shqipëria si vend sepse do të popullohet gjithnjë e më shumë me njerëz të papunë e të diplomuar dhe njëkohësisht do të zbrazet nga të rinjtë e vet. E pra, në të gjithë këtë strategji, e vetmja e papritur e pallogaritur ishte protesta e studentëve.

E si zakonisht, në protestë të studentëve morën pjesë militantët e partive.

Në dhjetorin e dytë, ashtu si në të parin, kur Partia e Punës dërgoi emisarët e vet, futën kokat emisarët. Janë të dy llojeve: ata që kanë për mision ta shuajnë protestën, dhe ata që duan ta devijojnë protestën prej rrëzimit të ligjit të arsimit. Ndaj në këto kushte, studentët nuk duhet të



harrojnë se arroganca e pushtetit, cinizmi i Ramës, oligarkia e sistemit është pikërisht në ligjin e arsimit. Studentët nuk duhet të harrojnë se zemra e protestës është bllokimi i njëjete universitare të sabotuar, pra bllokimi i vetë universiteteve. Protestat në shesh le të bëhen në data e vende të caktuara, por mbi të gjitha universiteti duhet t'i kthehet studentit.

Duke e bllokuar funksionin e gënjeshtert të universitetit dhe duke reflektuar e duke e jetuar atë në diskutime dhe lexime, prej këndvështrimit teorik dhe konkretësisë ligjore, studentët më në fund mund të mbërrijnë në statusin e tyre të vërtetë, në njohës profesionalë dhe intelektualë të fushave të tyre. Pra, ta sjellin universitetin në një status që duhet ta kishte parimisht, por që nuk e ka pasur kurrë në Shqipëri. Kjo do të detyronte edhe profesorët të sillleshin ashtu siç duhet të jenë në natyrën e tyre: studentë dhe intelektualë njëherësh. Sigurisht që do të afrohehesh më shumë pedagogët e ndërgjegjshëm dhe të sigurt për dijen e tyre.

Nuk ka mënyrë më të mirë kundër arrogancës oligarke dhe cinizmit pushtetar të qeverisë se

ngritja profesionale dhe intelektuale e studentëve. Studentët janë të shumtë në numër dhe shumica e tyre e madhe nuk kanë as idenë më të vogël se sa e bukur është jeta e rinisë universitare. Universiteti ynë ka qenë një vend i boshatisur nga inteligjenca dhe krijimtaria. Kafja dhe të mësuarit përmendësh i kanë shkuar për shtat identifikimit të universitetit me një dyqan diplomash dhe gradash. Plagjiatura është emri më i ndyrë që i ka rënë në supe universitetit shqiptar. Ai është shndërruar në vendin që furnizon grada e tituj për mercenaritet e pushtetit, për ministrinë e partive dhe për injorancën e deputetëve.

Protesta do të jetë e gjithanshme nëse shoqëria shqiptare zbulon dhe mbron tërë vendet e dijes dhe krijimtarisë. Deri tani po shohim vetëm protestën për mbrojtjen e Teatrit Kombëtar dhe atë të studentëve për mbrojtjen e universitetit publik. Shumë vende dhe institucione të tjera të krijimit dhe shkencës janë zhdukur.

Nëse mbrojmë kombëtarisht dhe publikisht, në përmasën e tyre kombëtare dhe publike, institucionet që janë ende, do të mund të kthejmë edhe ata që janë

zhdukur prej dhe për interesa të kompanive të betonit dhe zbardhjes së parave të kanabisit. Betoni dhe konkretja i pëlqejnë shumë oligarkisë së kanabisit. Shoqëria e vërtetë ka nevojë për ide dhe virtualitete, për virtutë dhe virtuositet. Universiteti, Teatri, tërë vendet e shkencës dhe artit e pajisin një shoqëri me shumë burime vullneti dhe me shumë besim e shpresë. Zgjojnë të njeriu, e sidomos tek i riu, para së gjithash të studentit, shumë forma talentesh, të gjimnazistit shumë shije e dije të mundshme.

Protesta e studentëve është një pasurim i vërtetë i imagjinatës politike. Prandaj, te qytetarët ngjizet një shpresë sado lind një lëvizje sado e vogël studentore. Nëse protesta vijon më tej, shpresa mbahet gjallë dhe shoqëria si bashkësi qytetare dhe politike merr jetë. Mbyllja e protestës është rënie në batakun dhe mjerimin e jetës së rëndomtë.

Proteston, pra ekziston. Ose, ndryshe: punën e rinisë së sotme mos e lërë për rininë e nesërme. Përndryshe do të jesh një brez më i vjetër e shumëfish brezash më i pabesë.

* Marrë nga "Facebook" i autorit

HOROSKOPI

DASHI

Disa persona të kësaj shenje mund të përjetojnë një kthesë në jetën e tyre. Ata që janë në kërkim të dashurisë ka gjasa që t'i japin fund vetmisë. Ndërsa disa të tjerë mund t'i japin fund lidhjes së tyre romantike.

DEMI

Disa Dema mund të ëndërrrojnë për diçka materiale: makinë ose shtëpi të re. Megjithatë, ëndrrën mund ta ktheni në qëllim për të ardhmen. Marrëdhënia juaj romantike do të përmirësohet dukshëm.

BINJAKET

Gjatë kësaj dite Binjakët duhet të bëjnë shumë kujdes me ushqimin. Ka gjasa të konsumoni diçka që mund t'ju shkaktojë dhimbje stomaku. Dikush mund t'ju bëjë një vizitë të papritur, por shumë të këndshme.

GAFORJA

Gaforret nuk duhet të harrojnë sesa e rëndësishme është të ndihen mirë emocionalisht. Nuk do të ndiheni aspak mirë nëse u kundërpërgjigjeni provokimeve. Përpuni të shmangni konfliktet dhe të ruani qetësinë.

LUANI

Luanët këshillohen të heqin dorë nga gjërat e vjetra, shqetësimet e pa-nevojshme dhe ankthet. Ndijni intuitën dhe mos u bazoni vetëm te këshillat e të tjerëve. Do të kaloni një mbrëmje të qetë romantike.

VRIGJERESHA

Disa persona të kësaj shenje do të kërkojnë ndihmë nga miqtë e tyre të ngushtë. Ka gjasa të merrni një ofertë të re pune shumë më fitimprurëse se ajo aktuale. Mos vendosni pa u menduar mirë.

PESHORJA

Do të kaloni një ditë të kënaqshme, pavarësisht se do të ndiheni të lodhur në fund të ditës. Mund të përballeni me disa mosmarrëveshje në familje, por do t'i kaloni shumë shpejt. Përpuni të qëndroni vetëm nën praninë e personave që u bëjnë të ndihni komod.

AKREPI

Akrepat nuk duhet ta kalojnë ditën me konflikte, konkurrenca qesharake apo me mendime negative. Përpuni që në fundjavë të relaksoheni sa më shumë, pasi e keni të nevojshme. Duhet t'i kushtoni rëndësi dietës ushqimore dhe ushtrime fizike.

SHIGJETARI

Mbrohuni nga informacionet që ju shoqësojnë drejtpërdrejt. Rekomandohet të bëni joga apo aktivitete të tjera relaksuese. Ka gjasa të zhgënjeheni nga partner/partnerja juaj. Madje, disa mund të shkojnë drejt ndarjes.

BRICJAPI

Të gjitha telashet me të cilat do të përballeni sot kanë të bëjnë me ndjenjat. Do të keni mosmarrëveshje me partnerin/partneren tuaj. Ndërsa mbrëmja do të jetë më e qetë. Rekomandohet të takoni miq/miqen tuaj të ngushtë.


UJORI

Do të ndiheni të dobishëm duke u marrë me sport. Mundohuni të inkurajoni edhe shokët e të afërmit tuaj që t'i përkushtohen aktiviteteve fizik. Për Ujorët e vetmuar, sportet do të ndihmojnë për të bërë disa njohje emocionuese.

PESHQIT

Sot mund të ndjeni dëshirën për ndryshim, por mos nxitoni të bëni ndryshime rrënjësore. Filloni nga gjërat e vogla, duke u kujdesur për problemet më kritike. Për të rivendosur mirëqenien financiare, shmangni shpenzimet e luksit dhe udhëtimet e gjata.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Salacrou dramaturg
- Blair e Ekzorçisti.
- I bylyllit ai i Mjedës.
- Initialiet e Morricones
- Gjysmë vektor.
- Një port përballë Xhibutit.
- Në mes të Salt dhe City.
- Janë stacionet e beduinëve.
- Një pjesë e taktikës.
- Janë tifozë partie.
- Janë firmat mashtruese.
- Përpunojnë naftë.
- Janë konservatorë.
- Eshtë derri.
- Një monedhë maqedonase.
- Kufizojnë ambiente.
- Initialiet e Gould aktor.
- Fillojnë jetën.
- Janë dëshmorët.

- U shkrua nga Garcia Lorca.
- Janë baballarët.
- Tregon çmimin dhe modelin.
- Eshtë ujëvara.
- Një mund të jetë mbi xhiro.

VERTIKAL

- Film i James Cameron.
- Jeronim de i Milosaos.
- Eshtë doktori me bluzë të bardhë.
- Agjenci Informacioni Ndërkombëtar.
- Janë si jerm.
- Fillojnë lejen.
- Klikohet me mouse
- Një vegël.
- Luftohet me kinina.
- Janë cilësi.
- Janë reaksionet në epruveta
- Një sportist që kërcen me shkop.
- Janë tek në zhele
- Eshtë kullë xhamie.
- Bëhet një për zakon.
- Gruaja e Fantozzi-t
- Gjysmë afërsi.
- Janë ndriçues.
- Nuk duhet shkelur një i tillë.
- U shkel për herë të oarë nga Neil Armstrong.
- Një fjalë për gjoja.
- Garbo e kinemasë.
- Braktisi Didonën.
- Me të bëjnë një thikë.
- Mund të jetë gjaku.
- Janë dhoma.
- Ai dhe ajo.
- Ushtria republikane irlandeze.
- Agjenci Transporti Korçë.
- Me stpon në box.
- Initialiet e Moravia-s.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Ishte babai i parë.
- Indërmarrim progresistët.
- Thyhet një me kohën më të mirë.
- U braktis nga Helena.
- Seritë pa zë.
- Kryeqyteti i Kinës.
- Ramazzotti këngëtar.
- Eshtë sport me vozitje.
- Ndërmarre Industriale Rajonale.
- Janë sherre në shtyp.
- Initialiet e Clapton.
- Eshtë shuma e brinjëve të drejtkëndëshit.
- Një letrar është tregimi.
- Fillojnë nazet.
- Matet pa kufij.
- Initialiet e Kokoschka piktor
- Kufiojnë mendimet.
- Bergman që qe aktore.
- Eshtë shpërblimi në para.

VERTIKAL


- Wenger trainer.
- Stefan i interpretuar nga Horst Tappert
- Një është edhe Bujar Lako
- Fillojnë mobilizimin.
- Institucione Rajonale Polake.
- Një rapper i famshëm.
- Kështu thirrej Ronaldo, bombieri brazilian
- Ndëzur në aparatë.
- Një film i ribërë.
- Ekstremit në model.
- Dy asa.
- Eshtë fytyra kamionit.
- Mund të bëhet me medalje trimërie.
- Mund të jenë të rastit.
- E ka simbolin Ti.
- Eshtë dëm, qeder.
- Initialiet e Tappert.
- Një pjesë e pejsazhit.
- Ndahet në barazim.
- Janë kandilë deti
- Hayeorth që qe aktore
- Eshtë enë për të skuqur.
- Emri i Zola.
- Gjysma e globit.
- Janë në skaje.
- Kryqyteti i Letonisë.
- Eva... Isabel Allende-s
- Një stacion i famshëm orbital
- Initialiet e Lennon.
- Diftong në duet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

1	9		5				6	4
	4				8	7		
	7	8	1				9	
7								
			3	7	9	2		
		9		1	4	3	5	
5	2		3	6	4	7		
1						6	8	
8			9				3	

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	8	4	2	5	9	3	7	6
9	3	6	8	1	7	4	2	5
5	7	2	4	6	3	8	9	1
6	9	3	1	2	4	5	8	7
8	1	7	3	9	5	6	4	2
2	4	5	6	7	8	9	1	3
4	5	8	7	3	2	1	6	9
7	6	9	5	4	1	2	3	8
3	2	1	9	8	6	7	5	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Jeta është gjithmonë duke pritur kohën e përshatshme për veprim.

- Ndonjëherë jeta i ndan dy njerëz vetëm për të treguar se sa të rëndësishëm janë ata për njëri-tjetrin.

- Ajo që ndodh një herë, nuk mund të ndodhë përsëri. Por ajo që ndodh dy herë, patjetër do të ndodh dhe për së treti.

- Të gjithë jetojmë nën të njëjtin qiell, por jo të gjithë kemi të njëjtin horizont.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

14	5	1	8	2	9	2	6	15	9	2	17	11	
6		6	5	8	2	6		8	2	8	2	14	
	11	4	12	2	7		6	2	11	2		3	
8	2	9	4	6	3		6	9	15	9	3		
4	6	2	6				4	6	3	14		17	
8	5	13	19		4	9	3				3	15	6
3	7		6	19	12	3		4	12		11	4	
6	3	9	2	13	4	6		9	3	12	2	6	
4	13		6	3	6	2	13	3	11	4		4	
6	2	15		4	9		11	15	9	2	6		

P	U	S	I	K	U	P	T	O	P
U	R	A	R	O	A	S	L	I	
S	I	P	E	L	E	R	I	N	A
H	P	A	N	O	R	A	M	A	T
T	R	I	P	A	N	O	Z	O	M
E	P	A	T	A	T	I	N	A	T
T	E	S	A	I	T	T	O	D	
I	A	R	P	R	A	N	I	M	E
R	I	C	H	T	E	R	S	I	L
S	T	I	L	E	T	E	U	K	E
R	U	Z		A	T	R	E		
R	I	C	H	A	R	D	T	A	

- Nëse dashuria transformon një person me shpejtësi, dëshpërimi e bën atë edhe më shpejt.
- Sapo kam gjetur të gjitha përgjigjet, menjëherë ndryshuan të gjitha pyetjet.
- Gjithmonë të shprehni atë që ndjeni dhe të bëni atë që mendoni! Heshitja shkatërron jetën ...

- Subjektet nuk duhet të shumëzohen përtej asaj që është e domosdoshme.
- Nëse një pemë bie në pyll dhe askush nuk është atje për ta degjuar atë, do të bëjë zhurmë?
- Një hap i vogël për njëriun, një hap i madh për njëriun.

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIJE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



